



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 04.07.2016, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Mucmata, Petrit Vasili.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Agnes Bernhard, eksperte e Nivelit të Lartë, zëvendëssefe e Misionit EURALIUS

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Në rendin e ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdojmë me nenin 33 “Kriteret e pranimit në formimin fillestar”.

Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo është një risi, që është për t’u vlerësuar. Këtu janë dy çështje të cilave duhet t’u japim vëmendje dhe duhet të mbajmë shënime.

E para, një nga kriteret për t’u pranuar në formimin fillestar është dhënia e provimit të shtetit për jurist, ndërkohë që ligji për provimin e shtetit është në proces. Në këtë kuadër, është e nevojshme të kemi një dispozitë kalimtare se si do të veprohet, për aq kohë sa ligji për provimin e shtetit nuk është miratuar.

E dyta, nga pikëpamja e teknikës legjislative germa “c” riformulohet, qartësohet. Gjithashtu, lidhur me kriteret që duhet të plotësojnë personat për t’u pranuar në Shkollën e Magjistraturës në germën “ç”, ndër të tjera, përmendet edhe mësimdhënia në fakultetet e drejtësisë. Pyetja ime është: çdo pedagog i brendshëm apo i jashtëm, pavarësisht se ka vetëm emrin, ka dhënë apo nuk ka dhënë orë, do të pranohet si një kandidaturë e mundshme për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës?

Lidhur me germën “d”, sugjeroj që ajo të formulohet duke pasur parasysh vendimet gjyqësore të formës së prerë. Pra, do të pranojmë të mos jetë dënuar asnjëherë me vendim gjyqësor përfundimtar, apo do të themi me vendim gjyqësor të formës së prerë?

Gjithashtu, për ta mbyllur këtë nen, dua të di qëndrimin e ekspertëve lidhur me periudhën transitore deri në miratimin e ligjit të provimit të shtetit, ose nëse ju si kryetar i komisionit keni një informacion.

**Agnes Bernhard** –(flet anglisht) Ne jemi dakord me këtë qëndrim.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 34.

**Vasilika Hysi** – Bëhet thjesht një formulim sipas tabelës. Domethënë, është thjesht teknikë legjislative.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 35 “Aplikimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me pikën 2 të nenit 35, ku thuhet: “Nëse është e nevojshme, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nga organet publike ose nga punëdhënësit e kandidatit”, mendoj se është shumë subjektive. Kemi bërë një riformulim, pra të thuhet: “Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. Pra, të mos jetë subjektive, por të ketë disa arsye kur mund të kërkojë informacion shtesë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Miratohet me ndryshimet.

Neni 36 “Provimi”.

**Vasilika Hysi** – Këto nene janë pjesë e ligjit të Shkollës së Magjistraturës. Ne në mbledhjen e kaluar vendosëm që ligjin për Shkollën e Magjistraturës ta përfshijmë në ligjin e ri për qeverisjen e gjyqësorit. I vetmi sugjerim dhe merak që kam është të jemi shumë të kujdesshëm që dispozitat, të cilat janë parashikuar te konkurrimi, ose provimi i pranimit, të mos jenë te ligji për qeverisjen. Këtë e kam për zotin Ibrahim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Si një koment të përgjithshëm për këtë pikë, ka pasur një bashkëpunim ndërmjet grupeve të bashkëpunimit për Shkollën e Magjistraturës dhe jemi përpjekur që të sigurohemi që në statuskuo të përfshihen detyrimet, ndërsa në ligjin e magjistraturës, si pjesë e të gjitha rregullimeve të bëra për Shkollën e Magjistraturës, do të jenë vetëm ligjet për magjistraturën. Ato do të jenë paralel me njëri-tjetrin dhe do të plotësojnë njëri-tjetrin.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, kini kujdes me përkthimin e terminologjisë, sepse nuk do të jenë ligje, por amendamente, që të jemi të saktë, se po regjistrohet kjo.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, te pika 3 e këtij neni duhet të tregojmë kujdes. Kjo është për këshilltarët. Me përfshirjen e ligjit të Shkollës së Magjistraturës tek ligji, të bëjnë edhe rregullin përkatës, pra referencën.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord me nenin 36.

Neni 37. A keni gjë?

**Vasilika Hysi** – Janë çështje të redaktimit sipas tabelës.

**Fatmir Xhafaj** – Janë të gjitha të përfshira në tabelë.

Neni 38.

**Vasilika Hysi** – Mendoj që në vend të fjalës “profesional”, të përdorim fjalët “praktikë profesionale.

Gjithashtu, kemi bërë edhe shqipërime të fjalëve, si nga “ambient” në “mjedis” etj., sipas tabelës.

**Fatmir Xhafaj** – Jemi dakord me ndryshimet e nenit 38.

Neni 39. A jeni dakord?

**Vasilika Hysi** – Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Kthehemi te neni 33.

**Petrit Vasili** – Te germa “c” e nenit 33, te “Kriteret pranimit” thuhet: “Ka mbaruar ciklin e dytë të studimeve për jurist në Shqipëri ose të barasvlershëm me të brenda vendit me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, në rastin e një diplome të barasvlershme të një vendi të huaj, të njësuar sipas rregullave për diplomat të parashikuara me ligj me 70% të pikëve të marra në universitet.” Pyetja ime është kjo: këta, kur konkurrojnë, e kanë kriterin e mesatares?

**Fatmir Xhafaj** – Po, është dysheme.

**Petrit Vasili** – Pse vihet ky 70% për këta që kanë mbaruar jashtë?

**Fatmir Xhafaj** – Sepse është një sistem i ndryshëm nga këtu. Vëmë notë mesatare dhe e heqim këtë, por e rëndon. Ishte ai shqetësimi herën e kaluar që u jepet më shumë akses këtyre.

**Petrit Vasili** – Jo, e kam fjalën që të thjeshtohet fare. Dihet që në çdo shkollë rankimi sipas mesatares është ose promovues, ose penalizues, sepse një mesatare e ulët ka pak pikë, kurse një mesatare e lartë ka shumë pikë. Duke e lënë në këtë mënyrë, gara vetvetiu do ta bëjë këtë ndarje dhe nuk kemi pse vëmë kufij të tillë, sepse, në fund të fundit, ajo është një garë objektive. Unë që kam mesatare më të lartë jam më i avantazhuar. Nuk vë kufizime të tilla, sepse krijohen probleme. Problemi është kriteri... Sipas kriterëve të paracaktuara nga shkolla, duke pasur kriterë promovuese mesataren më të lartë dhe duke vënë dysheme të tilla, ne vetëm krijojmë idenë e diskriminimit. Absolutisht, gara është e hapur. Kush e ka këtë mundësi të ecë, do të ecë. Kush e ka mesataren e ulët, është i penalizuar, se ka më pak pikë.

**Fatmir Xhafaj** – Jam dakord, por ka një dysheme dhe është normale kjo gjë, sepse ai që ka mesataren 5 nuk mund të konkurrojë në Shkollën e Magjistraturës, siç ndodh sot në universitet, për shembull, ku për degë të caktuara vihet një dysheme.

**Petrit Vasili** – Ne, Fatmir, ti e di shumë mirë që një nga gjërat më të mëdha që kemi bërë në maxhorancën që shkoi ishte që hoqëm mesataren, pavarësisht se kemi bërë 17 hapa mbrapa që po vëmë përsëri mesataren. E gjithë bota e qytetëruar thotë: ti ke mesatare të ulët, pra që në fillim kë një disavantazh të madh, por është puna jote që e ke këtë disavantazh.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe në shkollat e tjera ka një dysheme. Të gjitha kanë një dysheme. Problemi është që kjo dysheme duhet të njësohet. Mund ta ulim këtë dysheme. Pastaj është lënë e hapur ajo. Por ajo është kudo që ka Shkollë Magjistrature.

**Petrit Vasili** – Po ju bëj një pyetje shumë të thjeshtë: ne nga çfarë e mbrojmë shkollën, se kemi frikë që do të fitojë edhe një student me mesatare shumë të ulët? Po ju bëj një pyetje shumë të singertë. Nga 10 te 5, kjo 5 ime vlen 5 pikë, kurse ajo 7 e këtij do të vlejë 20, unë i kam 15 disavantazh, por duhet të krijoj mundësi: po të duash, tento. Në këtë pikë ne edhe jemi shumë demokratikë, edhe kthehemi dhe bëhemi anakronikë. Unë jam i penalizuar që në start, por ama ka një gjë që nuk jam i diskriminuar. Kam të drejtë të tentoj. Mbase për një seri rrethanash nuk ka interesa të tjera të njerëzve të caktuar, pse e vëmë këtë kufizim?! Kufizimi ka një gjë: është një pamundësi absolute, kurse gara e hapur nuk e tremb asnjërin. Dihet që edhe 7-a me 9-ën kanë një diferencë të madhe. E dini pse e them këtë gjë?! Në këtë sistem është më mirë të ketë një garë, e cila i ka të qarta kriteret dhe e di shumë mirë dhe jep mesazhin që mesatarja e ulët nuk është një favor dhe ti e di vetën që në start që je i pafavorizuar dhe e lë garën. Ideja që të vëmë një mesatare 7 nuk më duket... Po me atë me mesatare 6,9 çfarë bëhet? Ky ka qenë edhe problem i madh i demokracisë.

**Fatmir Xhafaj** – Po në mjekësi, meqë është edhe profesioni juaj, ju e dini që, po nuk kape një numër të caktuar pikësh, nuk hyn dot, pra po nuk pate një mesatare të caktuar?!

**Petrit Vasili** – E kanë specializimet. Ta them unë si është.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe specializanti nuk hyn dot. Edhe në universitet nuk hyn dot.

**Petrit Vasili** – Ai që ka pikë më të larta të penalizon, por...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk hyn fare. Nuk të pranon.

**Petrit Vasili** – Janë vënë tani, se më përpara nuk kanë qenë.

**Fatmir Xhafaj** – Është bërë një sistem i tillë dhe shkolla ka 20 vjet që operon me këtë sistem.

**Petrit Vasili** – Jo.

**Fatmir Xhafaj** – Shkolla e Magjistraturës po, që nga dita e parë që është krijuar dhe deri më sot.

**Petrit Vasili** – Koncepti i mesatares ka qenë një koncept, për të cilin ka pasur debate shumë të mëdha. Ne (pavarësisht se e kemi amnezuar krejtësisht historinë tonë, edhe si të majtë, mirë kemi bërë që kemi harruar se, kur na kujtohen sukseset, na vënë në siklet) ne na kanë duartrokatur të gjithë njerëzit ditën kur hoqëm mesataren. Mesatarja ishte konsideruar dhe konsiderohet një moment manipulativ shumë i poshtër. Ka qenë një çlirim i madh që u hoq ajo mesatare. Futja e mesatares nuk e ka përmirësuar as cilësinë e shkollave dhe as të arsimit. Por ka bërë që raporti me notën të jetë objektiv. Çfarë ndodh? Ne duke mbajtur këtë gjë, absolutisht s'i bëjmë ndonjë të keqe garës. Pse do të lodhen ata që do të seleksionojnë edhe 5 kandidatë më shumë?! Po ta thjeshtosh, ky është i gjithë problemi. Nuk do të aplikojnë 20, por 30.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, do të aplikojnë 300.

**Petrit Vasili** – Po le të aplikojnë 300.

**Fatmir Xhafaj** – E para, do të aplikojnë 300 dhe e dyta është bashkimi i një mundi disavjeçar me një rezultat të momentit, sepse ai mund të kapë një rezultat të momentit, pra me pyetësin e momentit, por formimi i tij bazë nuk është cilësor. Duhet ta pranojmë këtë gjë. Një njeri, i cili ka marrë gjatë gjithë kohës 5, nuk mund të shkojë në Shkollën e Magjistraturës.

**Petrit Vasili** – Nuk fiton ai. Mirë do ta vëmë 7.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, mund ta ulim.

**Petrit Vasili** – Ja e vumë 7, po ai që e ka...

**Fatmir Xhafaj** – Unë nuk e vë 7 me brezin që është sot.

**Petrit Vasili** – Po 8? Po unë, Fatmir, që nuk mora një provim dhe e kam mesataren 7,9, pra jam 0,1 poshtë mesatares?! Pra, a e kemi shpirtin e qetë ne? Ne jemi vetë prindër fëmijësh. Në qoftë se është njëri atje (kush e mbaron në Shqipëri e ka më keq këtë punë), i cili ka inatim tim apo tëndin, e u ul një notë në mënyrë subjektive. Një nga arsyet kryesore edhe në Europë që u braktis mesatarja, edhe ne bëmë mirë që e braktisëm, ishte për shkak se ishin këto gjërat në kufi, të cilat krijojnë një diskriminim të madh. Ndërkohë që ti e ke 7, e merr, kurse ti që e ke nën 7, i humb 10 pikët.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Vasili, se edhe këto shkollat e tjera të Magjistraturës që e kanë, për shembull, në Francë, sepse e di që e ka, sepse na u desh ta shinin (nuk po them për të tjerat, sepse nuk jam shumë i sigurt për momentin) nuk besoj se e kanë vendosur rastësisht një dysHEME, sepse ato mund ta linin të hapur.

**Petrit Vasili** – Kam edhe diçka tjetër për të thënë. Absolutisht që unë e vlerësoj shkollën shqiptare, pa diskutim që po, sepse produkt i asaj shkollë jam, por ne nuk kemi të njëjtin kriter objektiviteti në vlerësim në shkollat tona. Atje ka lindur, sepse objektiviteti ka qenë gjithmonë, ka qindra vjet, pra edhe atje nuk u kultivua në një ditë, por u arrit të ishte i tillë. Subjektivizmi ynë mund të jetë penalizues, sepse ne vetë përditë flasim për historitë e arsimit shqiptar. Së paku, kjo gara nuk i penazlion, nuk i tmerron. Ky është një hap i vështirë, por duhet të mendohet, sepse ne kemi vuajtur edhe para '90-ës, kur ka pasur një shtet të fortë, por nota përsëri nuk i shpëtoi fiktivitetit. Ju e mbani mend këtë gjë. Të paktën unë e ti e mbajmë mend.

**Fatmir Xhafaj** – Unë dhe ti jemi rritur me edukatën e mesatares.

**Petrit Vasili** – Mbaj mend se çfarë nuk bëhej me këtë punë. Kur hoq, thamë: shyqyr shpëtuam nga kjo gjë. Do të vijë koha kur edhe shkolla jonë të konsolidohet edhe më tepër dhe do të jetë edhe më ekzigjente në vlerësimet që bën dhe sigurisht që edhe ne kemi të drejtë të flasim për këtë gjë. Duke ditur këtë lloj floktacion të madh, ta bëjmë në këtë mënyrë... Unë nuk kam asnjë gjë që më lidh drejtpërdrejt me këtë punë, flas në pikëpamjen e kritereve. Për mua kjo ekzigjencë kaq e madhe dhe ky skolasizëm në momente të caktuara nuk na ndihmon. Vërtet e bën Franca, por nuk mund të pretendojmë të kemi universitetet franceze. Historia e universiteteve franceze është qindra vjeçare. Nuk është histori e tillë, ku historia e universiteteve të hapura është 25 vjeçare. Tjetra është historia e një sistemi arsimor që ka pak të ngjarë.

Jua them sinqerisht: në qoftë se ju jeni të qetë, unë nuk jam i qetë.

**Fatmir Xhafaj** – Të them të drejtën, unë e konsideroj këtë shumë të rëndësishme dhe kam një diferencë në mendim për këtë çështje, sepse kjo ka të bëjë me cilësinë e Shkollës së Magjistraturës. Gjithsesi, unë nuk e di si janë standardet, por, me aq sa e di unë, ky lloj kufizimi pozitiv i shërben cilësisë së shkollës. Të kuptohemi që janë shumë pak njerëz që hyjnë në Shkollën e Magjistraturës. Nëse do të krijojmë gara fiktive, mund të dëmtohet cilësia e shkollës. Nëse është formuluar saktë apo jo, këtë nuk e di, se duhet parë.

**Petrit Vasili** – Atëherë, ne jemi të gjithë të bindur, se e kemi kufizimin e mesatares, sepse kemi frikë që kandidati me mesatare të ulët mund të bëjë bingo kur bën pyetësin. Në

qoftë se është kështu, i gjithë mekanizmi i pranimit, që është ndërtuar, është i gabuar. Le të mos bëhet pyetësor, por të gjendet një mënyrë e të pyeturit të kandidatëve që tregon formimin e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Ajo është shumë subjektive pastaj, se pastaj do të kalonte në zgjidhje klienteliste dhe do të ishte e rrezikshme për shkollën, e cila ka rezistuar. Zoti Vasili, unë nuk i njoh degët e tjera të universiteteve, por njoh sistemin e drejtësisë në këtë vend. Në qoftë se ka në drejtësinë shqiptare, në sistemin e edukimit dhe të formimit si jurist një shkollë, e cila ka rezistuar në këta 15 vjet, pavarësisht se çfarë ka ndodhur me sistemin arsimor, është Shkolla e Magjistraturës, falë trupës pedagogjike që ka punuar gjatë 15 vjetëve që nga viti 1998 aty, në mënyrë të veçantë falë kontrollit të ashpër, rigoroz të partnerëve ndërkombëtarë. Nuk e di sa jeni në dijeni të faktit që i gjithë sistemi i provimit, i testimit në shkollë, është një bashkëpunim i dyanshëm ndërmjet trupës pedagogjike shqiptare dhe ekspertëve ndërkombëtarë, por kjo është e vijueshme. Mendoj se kjo e ka shpëtuar shkollën nga presionet, nga interesat, nga subjektivizmi, duke ruajtur në njëfarë mënyrë cilësinë. A ka vend për t’u përmirësuar?! Pa dyshim që ka vend për përmirësim. Por, nëse kjo është një gjë që e përmirëson, unë nuk e kam bindjen.

**Petrit Vasili** – Unë do të bëj komente më të gjatë, sepse është e gjithë kjo punë për t’u bërë. Komenti im i fundit është: unë dhe ti, Fatmir, kemi studiuar shkolla që nuk kanë pasur pyetësorë. Nuk më duket se jemi shkolluar keq. Madje, kemi pasur edhe fatin të përballemi edhe me shkollat në Perëndim, kur kemi vajtur për studime dhe kemi rezultuar solidë. Po ju them se unë nuk jam as për fetishizimin e metodikave të verifikimit të dijeve dhe të shkollave. Këtu nuk dua të bëhem as i keq dhe as negativ. Po një pjesë e mirë e këtyre që janë shkolluar kaq mirë, kanë prodhuar atë drejtësi, të cilën ne po e shajmë dhe po bërtasim kot. Kështu që le të jemi të kursyer në vlerësimet për shkollat, se mirë na bën, sepse edhe ata që i kanë mbaruar këto shkolla dhe kanë marrë rezultate shumë të mira, pra ata më të mirë, kanë dhënë edhe vendime skandaloze, të cilat po na detyrojnë ta bëjmë drejtësinë nga e para.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk janë vendime që janë marrë për shkak të aftësisë, por për shkak të bindjes dhe të integritetit të tyre. Për shkak të aftësisë, skarciteti që mund të jetë nga shkolla është minimal, të paktën siç rezulton nga praktika dhe nga analizat që bëhen. Gjithsesi, sot që po flas, ndaj të njëjtën bindje në një pikë me ju: shkolla ka nevojë të forcojë të gjithë sistemin për të nxjerrë kuadër më cilësor, plus faktit që ka nevojë edhe për shumë ndryshime të tjera. Unë nuk do t’i fusja në shkollë ata që sapo kanë mbaruar Fakultetin e Juridikut, për shembull. Kjo është një çështje shumë e diskutueshme, duke qenë se duhet të kenë praktikë, të forcojnë integritetin, të



kenë mundësi të provojnë veten etj., pastaj të kalojnë në shkollë. Te ne është problem, se bëhesh gjyqtar 24-25 vjeç, kur je ende i pa përballur me praktikën dhe vendos për fatet njerëzore. Kjo është një gjë tjetër, të cilën jam i hapur, kur të vijë momenti, ta diskutojmë. Ndoshta kjo do ta ndryshonte të gjithë sistemin. Gjithsesi, ky është një riformulim.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, zoti kryetar, këtu ka disa kritere të reja. Në radhë të parë, është lloji i diplomës që duhet të ketë; provimi i shtetit, që është kriter i ri dhe për herë të parë nuk do të ketë studentë që do të konkurrojnë direkt nga bankat e shkollës, sepse në germën “ç” thuhet “kandidati ka të paktën 3 vjet përvojë profesionale aktive në sistemin gjyqësor, të prokurorisë, në administratë, në profesionet të lira, në mësimdhënie ose në çdo pozicion të barasvlershëm. Pra, shqetësimi që keni ju, por deri diku edhe shqetësimi i zotit Vasili, gjen rregullim tashmë. Edhe një student që ka mbaruar jashtë nuk mund të vijë nga jashtë shtetit dhe të konkurrojë direkt në Magjistraturë. Ai duhet të ketë të patën 3 vjet përvojë. Përvoja e konkurrimit vjet në Shkollën e Magjistraturës tregoi se studentët më të mirë që fituan, ishin ata që kishin kaluar provimin e avokatisë, kishin ushtruar profesionin e avokatit, pra nuk vinin direkt nga bankat e shkollës. E vetmja gjë që unë kam për germën “ç” dhe që e lashë për ta riformuluar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk më ndoqët. Unë fola, por ju po flisnit. Është provimi i shtetit. Pra, kriteri është se, pa dhënë provimin e shtetit, nuk fillon punë në asnjë institucion. Ndërkohë që unë po flisja, ju po flisnit me zotin Manja, po unë po jua them edhe një herë se duhet të saktësojmë se çfarë do të bëhet deri sa ligji për provimin e shtetit nuk ka hyrë ende në fuqi, pra për grupin e parë të studentëve. Këtu sugjerova dhe i kërkova edhe kryetarit të Komisionit të Reformës që, e para, të kemi kujdes të kemi një dispozitë kalimtare; e dyta, kur të miratohet ligji, të bëjmë referencën e saktë të ligji. Këto dy kushte janë të domosdoshme. Kur ka kaq shumë fakultete publike dhe private, kur shumica e studentëve diplomohen me tema diplomash, të cilat një pjesë e mirë i bëjnë vetë, por një pjesë tjetër nuk i bën vetë, por paguan për t'i marrë ato tema, të gjithë themi se nuk mund të pranosh një me mesatare 10, që ka mbaruar në një shkollë të paakredituar dhe t'i hapësh dyert e Shkollës së Magjistraturës. Ju do të thoni se kush e ka fajin?! Të gjithë ne që jemi këtu vijmë nga universitetet publike dhe jemi shkolluar 30, 31 apo 32 vjet më parë, por kemi dhënë provime shteti në atë kohë. Notat kanë qenë reale, ndërsa sot mund të kesh studentë që kanë mbaruar në shkolla private, që nuk kanë hyrë asnjë ditë në provim. Praktika e tregoi këtë, se

disa fakultete u mbyllën. Ata e kishin mesataren 10. Prandaj duhet ai provimi i shtetit, për të vënë në pozita të barabarta të gjithë studentë. Kjo ishte arsyeja që ne bëmë ndryshime edhe në ligjin e arsimit të lartë dhe futëm provimin e shtetit dhe ndërruam formimin e studentëve në fakultetin e drejtësisë nga 3+2, në një diplomë të integruar të nivelit të dytë, pra 5 vjet të plotë.

Germa “c” ka nevojë të riformulohet për t’u qartësuar, pastaj shikoni si do të vendosni.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, shikojeni këtë për ta riformulaur. Ndoshta duhet të bisedojmë edhe me ata që janë marrë me shkollën, domethënë edhe me ekspertët e huaj, të cilët njohin edhe modele të tjera, që të shohim si e kanë edhe ato.

**Petrit Vasili** – A është i detyrueshëm ky kriter, pra të ketë 5 vjet eksperiencë si gjyqtar ose si prokuror?

**Vasilika Hysi** – Nuk është 5 vjet, por është 3 vjet.

Te neni 33 është 3 vjet. Është tjetër gjë neni 38/3.

**Petrit Vasili** – Po pas dhënies së provimit të shtetit, a bie ky kriter, apo mbetet?

**Vasilika Hysi** – Në fakt, provimi i shtetit është një kusht për të kandiduar. Pra, mund të kesh mbaruar shkollën, por hapi i dytë është provimi i shtetit, që duhet dhënë, pastaj është përvoja. Pa dhënë provimin e shtetit, nuk garon për asnjë pozicion, as në administratën publike, as të hysh në konkurs për avokat, as për magjistraturë, pra për asnjë lloj pozicioni. Pra, zoti Vasili, kthehemi te provimi i shtetit që ke dhënë ti dhe unë para viteve '90.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ne e bëmë këtë profesion të rregulluar.

**Petrit Vasili** – Në momentin kur jepet provimi i shtetit, secili merr licencën profesionale. Ky është përkufizimi i provimit të shtetit. Në momentin që ka dhënë provimin e shtetit, mund të kandidojë qoftë për Shkollën e Magjistraturës, qoftë për t’u bërë neurokirurg, që nuk më duket një punë më pak e komplikuar se për t’u bërë magjistrat. Kështu që ne duhet të shprehmi qartë: kandidatët, të cilët japin provimin e shtetit, mund të futen dhe të garojnë për t’u futur në Shkollën e Magjistraturës. Nuk kemi pse vëmë stazh mbi provimin e shtetit. Kjo ka qenë çështje konceptuale.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me stazhin që ju kërkoni, duke iu referuar nenit 38...

**Petrit Vasili** – Nuk e kërkoj unë.

**Vasilika Hysi** – Neni 38 nuk ka të bëjë me magjistratët.

**Petrit Vasili** – Po flasim për tjetër gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Po flasim për atje ku e lamë diskutimin.

Mirë, le ta shikojmë të lidhur këtë: me provimin e shtetit, me stazhin 3-vjeçar dhe ta bëjmë këtë diskutim për nenin 33 për një riformulim.

Vasilika, kjo është fusha jote.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, ekspertët e nivelit të lartë që kanë punuar, dhe që kanë përvojë këtë duhet ta diskutojnë.

**Fatmir Xhafaj** – Po këto duhen parë në zinxhir, si funksionojnë. Bëjmë një minitryezë dhe ta shikojmë.

**Vasilika Hysi** – Jam dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me nenin 38.

**Vasilika Hysi** – Te neni 38 flitet për stazhin profesional të kandidatëve dhe kriteret që duhet të përmbushin magjistratët që do të jenë drejtues të tyre. Pra, kjo është një gjë pozitive, që ekziston edhe sot si stazh, si praktikë profesionale veçse rregullohet shumë, pasi i detyron këshillat të përcaktojnë rregullat dhe të caktojnë trupat e magjistratëve që do të udhëheqin për një periudhë të caktuar kandidatët për gjyqtarë dhe kandidatët për prokurorë. Në këtë nen, ashtu siç ju thashë, ka nevojë thjesht për riformulime të teknikës legjislative, të cilat i kemi bërë në tabelën përkatëse.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Neni 39.

**Vasilika Hysi** - Te neni 39 bëhet fjalë për listën e renditjes së të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës nuk ka probleme, është thjesht një diskutim që e bëra edhe me ekspertët e EURALIUS-it, pasi në ligj shpesh përdoret termi “kandidatë për magjistratë” dhe vende-vende përdoret termi “kandidatët magjistratë”. Dua që t’i unifikojmë, për të pasur një terminologji të njëjtë.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull.

Urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Te 39 është e nevojshme të jetë ligj fakti, që në çdo vit të muajt qershor shkolla publikon listën?

**Vasilika Hysi** – Patjetër.

**Petrit Vasili** – Për çfarë arsye?

**Vasilika Hysi** – Në fakt, zoti Vasili pyetja juaj është shumë e bukur: pse duhet të jetë në ligj detyrimi për shkollën? Shkolla ka detyrimin të bëjë transparente se kush janë studentët që janë diplomuar. Kjo është për transparencë, sepse studentët këtu janë të renditur sipas pikëve që kanë marrë, nga ai që renditet i pari tek ai i fundit, dhe këshillat, kur të bëjnë përzgjedhjen e tyre për emërimin qoftë të përkohshëm apo për ofrimin e vendeve, duhet të kenë parasysh këtë listë. Nga ana tjetër, kjo është një listë, e cila...

**Petrit Vasili** – Jam dakord që nuk është në nivelin ligjit, që një shkollë të publikojë rezultatet është një detyrimi më i zakonshëm administrativ i shkollës. Nuk është gjëkund në asnjë ligj. Mbi të njëjtat kritere çdo universitet... Nuk është Magjistratura një shkollë e padëgjuar dhe unike në sistemin universitar shqiptar apo pasuniversitar. Dakord për këto rregullat e tjera, se ka një lloj specifike, por që të nxjerrë rezultatet dhe t'i bëjë publike është detyrim ligjor për çdo universitet në Shqipëri. Merre dhe shikoje ligjin e arsimit të lartë, e ka detyrim. Ta vëmë ligj që të publikojë rezultatet në fund të muajit qershor, në qoftë se e bëri në korrik për një arsye të jashtëzakonshme aty, paska shkelur ligjin! Nuk është nen ky.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk duhet thënë “në fund të muajit qershor”, por duhet thënë “në fund të ciklit të studimeve”.

**Petrit Vasili** – Është detyrim.

**Fatmir Xhafaj** – Të gjitha detyrim i kanë këto.

Edhe një herë, do të ketë detyrimin që të bëjë renditjen, apo jo?

**Petrit Vasili** – Më fal, po ka një shkollë të lartë, e cila nuk ka detyrim të bëjë renditjen e kandidatit. Nuk është renditje, këto janë rezultate. Koncepti i renditjes, më falni, është pa kuptim. Ato janë rezultate dhe ato rezultate prodhojnë automatikisht një renditje të caktuar.

**Fatmir Xhafaj** – Siç ndodh në të gjitha shkollat.

**Petrit Vasili** – Në qoftë se doni ta dini, fjala “renditje” për mua është pa kuptim dhe është një term fare abuziv. Secili kandidat është regjistruar për të fituar rezultatet e tij. Secili kandidon në mënyrë individuale, nuk kandidohet me një listë kolektive. Pra, unë, Petrit Vasili, shkova në Shkollën e Magjistraturës dhe mora këto rezultate që janë individuale. Dhe këto rezultate të gjithsecilit nga ne bëhen publik atje dhe i shikojnë të gjithë. Secila është renditja në çdo vend ku ne konkurrojmë do të krijohet një renditje sipas këtij rezultati të shkollës, por edhe sipas ca kritereve të tjera, që unë do të shkoj të kandidojë. Ky është rregull.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, zoti Vasili, edhe sot për të hyrë në një institucion duhet të jesh i pari në listë për të filluar punë, nuk mund të filloi i pesti, i gjashti, i shtati. Lista është për transparencë.

**Petrit Vasili** – Vasilika çfarë po më thua, sepse po më çudit.

Unë po studioj një shkollë të lartë, që është Shkolla e Magjistraturës, dhe unë kam një raport individual me shkollën, nuk kam raport kolektiv; nuk më duhet fare sa ke dal ti. Shkolla ka detyrim që të gjitha rezultatet dhe në fund fare thotë: Petrit Vasili mesatarja 9 pikë ca, filani lista e provimeve....

**Fatmir Xhafaj** – Këtë ka parasysh ligji këtu.

**Petrit Vasili** - Çfarë do të thotë renditje? Edhe po e pranuan këtë nen, që është një ne kot, hajdeni të pranojmë të bëjmë publike rezultatet. Çfarë është kjo renditje?

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra kjo duhet thënë: “Bëhen publike rezultatet individuale të shkollës”, pa e vënë kufizimin, në mbyllje të ciklit duhet thënë pa vënë kufizimin në qershor apo në korrik. Ka të drejtë aty, zoti Vasili.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, po të shikoni këtë ligj, ky ligj ka afate. Ky ligj është shumë i detajuar, duke shmangur çdolloj mundësie për abuzim.

**Fatmir Xhafaj** – Mirë, por kur thuhet në fund të ciklit, cikli mund të mbarojë në mars, Vasilika.

**Vasilika Hysi** – Jo, cikli mbaron në qershor.

**Petrit Vasili** – O, Vasilika, mirë kjo shkollë e organizuar mirë, me kaq traditë të paparë, mund të jetë kaq e banalizuar, sa nuk bën dot publike rezultatet dhe duhet ta themi me ligj. Pastaj ta hajë mortja shkollën .

**Fatmir Xhafaj** - Ky është efekti i ligjit është ekzistues.

**Vasilika Hysi** – Zoti Vasili, ne kemi pasur përvojë, ju e dini shumë mirë që kemi magjistratë, që kishin mbaruar shkollën dhe nuk ishin emëruar; nuk ishin bërë prezent.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo nuk ka lidhje me këtë.

**Vasilika Hysi** – Nuk ishte bërë prezente as renditja e tyre. Ka një radhë në magjistraturë; kush ka marrë 100 pikë do të jetë i pari që do të fillojë punë në krahasim me tjetrin, sepse është meritokraci, është vlerësimi i meritave profesionale. Ai vlerësim që thoni ju, nuk është thjesht nota, por është edhe praktika.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Vasili, nuk e ka aty, nuk është se e kundërshton.

**Vasilika Hysi** - Unë nuk po kundërshtoj. Unë di edhe një gjë tjetër, që edhe ky magjistrati, të paktën në kuptim të këtij legjislacioni, nuk kam dëgjuar të ketë një emër automatik, apo nuk është kështu?

**Vasilika Hysi** – Sot e ka automatik.

**Petrit Vasili** – Si e ka automatik?

**Vasilika Hysi** – Sot të gjithë magjistratë...

**Petrit Vasili** – Më fal, nuk përmbush asnjë kriter ky njeri?

**Vasilika Hysi** - Ka një sërë kriteresh.

**Petrit Vasili** – Edhe rezultatet janë një kriter madhor, por është një kriter.

Po thamë këtë gjë që thoni ju, në dukje i bie që jemi para '90-ës, secili mbaronte dhe kishte vendin. Ti thua që ke rezultatin, por në rrugën e sipër, bashkë me kriteret e tjera, mund të ndodh që një nga kriteret e tjera, që ty të penalizojnë apo të garën e ngushtë ti me 100 pikë dhe unë me 99 pikë, bashkë me tjerat mund të jem unë, sepse e pranojmë që kemi një sërë kriteresh. Po pranuar që automatikisht ti mbaron shkollën, ke këtë dhe mbarove historitë e tua, ky është vlerësim mekanikisht.

**Vasilika Hysi** – Zoti Vasili, te paragrafi i dytë i këtij neni thuhet sesi renditen studentët të diplomuarit' dhe ka tri kriteret: janë rezultate e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, është provimi përfundimtar si dhe vlerësimi i praktikës profesionale. Pra, ka tri kriteret.

Këtu duhet të ketë transparencë, sepse nuk mund të kërcejë një i fundit, që mezi e kalon Shkollën e Magjistraturës, dhe të emërohet në Gjykatën Tiranës, apo të Fierit që është gjykata më e madhe, ndërkohë që duhet të ketë meritokraci. Në rastin e Shkollës së Magjistraturës, ashtu si edhe te mjekësia, ka disa degë që nuk mund të tolerosh, ke të bësh me jetën, ke të bësh me fatin e njerëzve.

**Petrit Vasili** – Në mjekësi nuk janë kështu siç i bëni ju, megjithëse...

**Vasilika Hysi** – Zoti Vasili, unë them se në mjekësi po, sepse ju nuk shkoni dot në specializim pa marrë provimin dhe pa pasur disa kriteret. Ka një vend kuotash dhe tek ato kuota që janë përcaktuar në specializimin në mjekësi nuk mund të futemi të gjithë, futet kush merr atë provimin. Ndërsa këtu është ndryshe. Aktualisht Shkolla e Magjistraturës ka 8 gjyqtarë dhe 7 prokurorë, e ka numrin e limituar.

**Petrit Vasili** – Po le ta hapi numrin, që të ketë më shumë.

**Vasilika Hysi** – Nuk mund të hapet, sepse ne totali i gjyqtarëve dhe i prokurorëve që kemi nevojë...

**Petrit Vasili** – Mungesë e garës e prish këtë...

**Vasilika Hysi** – Ajo është garë e fortë. Konkurrojnë 500-600 veta për 10 vende. Në ka shkollë që ka garë më të fortë, është Shkolla e Magjistraturës.

**Petrit Vasili** – Garat e mbyllura nuk i kanë shërbyer njeriut në botë. Bota bëri përpara kur i hapi garat.

**Vasilika Hysi** – Garën e bëjnë të gjithë. Të futen 600 vetë për 10 vende tregon.. Po ku do t'i çosh gjyqtarët dhe prokurorët më pas?

**Petrit Vasili** – Meqenëse u referove mjekësisë, po ata që mbarojnë për neurokirurgë?

**Vasilika Hysi** – Ka një problem zoti Vasili, ju dhe unë kemi paguar nga xhepi ynë për shkollën, ndërsa këtu paguan shteti për shkollën e tyre. Ata marrin rrogë në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të magjistraturës.

**Petrit Vasili** – Po pse, në mjekësi nuk marrin rrogë të gjithë specialistët?

**Vasilika Hysi** – Po, ata punojnë gjatë specializimit, kurse këtu vetëm në praktikë profesionale. Megjithatë, Shkolla e Magjistraturës ka një përvojë të mirë.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo ngrihet në funksion të nevojave që ka sistemi: nëse sistemi nuk ka nevojë, nuk ka arsye që të krijohen numra të tepërt në treg, që të shpërpjestojnë gjithë cilësinë e tregut.

**Vasilika Hysi** – Pastaj do bëhet si kurset që u bënë në '93-shin, prodhojmë me shumicë dhe pastaj kush të gjeje mikun, shokun të futet në sistem. Kjo e minon gjithë reformën në drejtësi më pas.

**Petrit Vasili** – Unë tërhiqem nga debati, të them të drejtën jo se më binde, por e shikoj që ndajmë dy botëkuptime të ndryshme. Unë nuk jam i botëkuptimit që më duhen 10 dhe të prodhojë 10, sepse në asnjë vend nuk funksionon bota kështu. Për mua kjo është betejë e humbur. Dua të them se garat e mbyllura, numrat e mbyllura e asfiksojnë zgjidhjen.

Kështu që unë jam për një shkollë me kapacitete paksa më të larta dhe absolutisht nuk i bën dëm sistemit, në qoftë se ka hapësirë zgjedhjes dhe mundësisë. Këtë e kanë provuar të gjithë sistemet e arsimit edhe të drejtësisë, prandaj kanë mundësi zgjedhësh më të mëdha. Kjo e bën shumë më mirë dhe më të shëndoshë shoqërinë. Kjo është çështje konceptuale dhe nuk kam në dorë që ta ndryshoj dot.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është vetëm çështje koncepti, duhet të nisemi nga qëllimi për të cilin është Shkolla e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës nuk ka funksion themelor formimin fillestar, ka funksion themelor formimi vazhdues. Që do të thotë se gjyqtarët dhe prokurorët e Republikës gjatë gjithë kohës që ushtrojnë profesionin e tyre janë të detyruar, për një numër të caktuar ditësh dhe orësh që të shkojnë për trajnim në Shkollën e Magjistraturës, gjatë çdo viti, për shkak se kanë nevojë që t'i rifreskojnë dijet e tyre; kanë nevojë adaptohen me legjislacionin e ri dhe me ndryshimet e reja të ligjit, kanë nevojë që të përshtaten me praktikën e njësuar në vend. Pra, funksioni themelor i shkollës është formimi vazhdues, krahas kësaj, shkolla ka detyrimin të përgatisë në raport me nevojat që ka edhe një numër të caktuar studentësh, të cilët janë kandidat të mundshëm për të hyrë në sistemin e drejtësisë si gjyqtarë, si prokurorë, si ndihmesa me sistemin e ri. Pra, e kemi zgjeruar praktikisht. Çfarë do të thotë kjo? Praktikisht, duhet të kalojnë në Shkollën e Magjistraturës edhe ata që janë ndihmësa ligjor, do të kalojnë në Shkollën e Magjistraturës edhe ata që punojnë ndihmësa të prokurorëve dhe të gjyqtarëve. Pra, vetvetiu ne kemi krijuar atë që thoni ju, me shumë të drejtë, një lloj rezerve, që në momentin që kemi nevojë për gjyqtarë dhe prokurorë, ne kemi një numër të madh njerëzish që janë në cilësinë e ndihmëseve, të këshilltarëve të gjykatave të Apelit, të Gjykatës së Lartë apo prokurorive, të cilët nga ky rezervat, me filtrat e tjerë, do të kalojnë në sistem për të marrë cilësinë e gjyqtarit apo të prokurorit.

Praktikisht, sot drejtpërsëdrejti nga Shkolla e Magjistraturës kalon në gjyqtar dhe prokuror. Me këtë reformë që po bëjmë, përveç disa filtrave të tjerë, që do të ketë, ai fillimisht do të kalojë në rolin e ndihmësit apo të këshilltarit dhe më pas do të jetë i gatshëm për të kaluar në Shkollën e Magjistraturës. Pra, do ta krijojnë vetvetiu këtë gjë. Po nëse ne më pas krijojmë një fond tjetër burimesh njerëzore, kjo do ta shpërpjestonte sistemin. Praktikisht e kemi hapur.

**Petrit Vasili** - A është në drejtësi kjo, praktikisht, realisht një shkollë e nivelit pasuniversitar të mirëfilltë? Kështu është, emrin e ka Shkollë të Magjistraturës, në mjekësi i thonë Shkollë e Shëndetit Publik, pra kjo është niveli pasuniversitar. Ky është nivel pasuniversitar që ka një jurist, që mbaron ciklin e plotë të integruar tashmë 3+2. Pra, ky si arsim pasuniversitar e ka emrin drejtësi, e ka emrin inxhinieri, e ka emrin mjekësi dhe le të themi shkatërron fatet njerëzve. Ai tjetri e bën një ndërtesë 20 katëshe, ai e hedh në shesh dhe vret 500 njerëzsh. Pra, do të thotë se kjo është shkolla pasuniversitare që ka juristë. Unë këtë po them. Duke qenë e tillë, është ky edhe një filtër i domosdoshëm, një patentë që marrin në dorë për të



synuar për të ecur në karrierën e tyre, që në vizion të ketë më shumë kapacite dhe më shumë mundësi, i bën mirë një sistemi.

**Fatmir Xhafaj** – Këtë kemi bërë zoti Vasili. Jemi në një gjatësi vale...

Edhe një herë: këta janë të detyruar të kalojnë një herë në rolin e ndihmësive, të punojnë ndihmësia, këshilltarë në Ministrinë e Drejtësisë, të punojnë ndihmësia në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, të punojnë në prokurori dhe ky numër i hapur për këtë lloj kategorie do të shërbejë më pas si burime njerëzore të mundshme për të kaluar për gjyqtarë dhe prokurorë, është një hapje shumë madhe e shkollës. Sot e kemi numër fiks, me vendet fikse që ka për gjyqtarë dhe prokurorë, kurse kështu 3-4-fishohet numri i atyre, që shkojnë në shkollë për gjyqtarë dhe prokurorë.

**Vasilika Hysi** – Për ta mbyllur këtë diskutim ligji i ri ka tre risi:

Së pari, Shkolla e Magjistraturës do të rrisë kapacitete e saj për shkak të rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit të aftësisë së gjyqtarëve, prokurorëve dhe i ndihmësive ligjorë do të bëjë që ata, që nuk kanë njohuri të mjaftueshme, por kalojnë me sukses procesin e vlerësimit të figurës morale dhe të pasurisë, janë të detyruar t'i nënshtrohen një formimi trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Pra, Shkolla e Magjistraturës i bie që vitin tjetër të ketë ngarkesë të madhe.

Së dyti, kemi zgjeruar atë që thatë ju, zoti kryetar, ndihmësit ligjorë që të kenë mundësi që të përfshihen në Shkollën e Magjistraturës.

Së treti, numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk e cakton Shkolla e Magjistraturës, janë këshilla, të cilat, duke bërë vlerësimin nevojave që kanë praktikë, do të përcaktojnë edhe numrin.

Ndërkohë mos të harrojmë se te ligji që diskutuam për hartat e gjykatave, për vlerësimin e stafeve, nuk mund të themi sot se sa është nevoja për magjistratë, sepse nuk e dimë ende se çfarë do të nxjerrë procesi i rivlerësimit të magjistratëve që aktualisht janë në sistem.

Nga ana tjetër, shkolla ka një kapacitet të limituar, nuk mund të bëhet masive sikundër janë bërë Fakultetet e Drejtësisë, pasi është e nivelit tjetër, është specializim dhe ka shumë punë praktike. Ka praktika edhe në terren. Një nga rregullimet që bën ligji, më pëlqen dhe e vlerësoj grupin e ekspertëve, është që ka rregulluar shumë mirë praktikën profesionale dhe magjistratët, të cilët do të monitorojnë dhe do të drejtojnë studentët magjistratët në praktikat e tyre, për të mos pasur një praktikë fiktive, por të jetë një praktikë reale.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Vazhdojmë me nenin 40.

**Vasilika Hysi** – Neni 40 ka të bëjë me emërimin e magjistratit të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ka rregulla, ku përfshihen që nga pikët që merr, verifikimi i pasurisë dhe i figurës, që kjo bëhet edhe para se të kandidojë edhe pasi të diplomohet. Këtu ka ndonjë riformulim fjalësh ose termash për t'i bërë në përputhje me teknikën legislative edhe me gjuhën shqipe.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Ulsi Manja** – Lidhur me emërimin magjistratëve pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, me këtë ligj shteti e mbart detyrimin që nëse nuk ka vakancë në sistem për të emëruar gjyqtarë dhe prokurorë, e mban detyrimin që deri në sistemimin e magjistratit të paguajë me rrogë kandidatët që janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, siç ndodh tani? Tani, ose të paktën, ka ndodhur ky fenomen. Periudha nga mbarimi i shkollës deri në ofrimin e vendit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka pasur raste që emërimi i magjistratëve ka zgjatur gati 2 vjet, që nuk janë emëruar pas mbarimit të Shkollës së Magjistraturës, dhe kjo është justifikuar për shkak të mungesës së vendeve në sistem. Është ndjekur rregulli që aq sa dalin nga sistemi, po aq kuota hapte Shkolla e Magjistraturës. Tani, me këtë ligj, me këto ndryshime do të ruhet ende ky detyrim i shtetit apo secili nga magjistratët deri në krijimin e vendeve të lira në sistem, do të ushtrojë profesionin e këshilltar ligjor, qoftë edhe në profesione të lira: noter, avokat. Domethënë, si është zgjidhur ky raport në këtë ligj?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Garancia që ligji përdor është kur këshilli detyrohet deri diku që t'i emërojë këta të emëruar një muaj pas publikimit të listës. Atëherë, kjo rregullohet në dispozitat e mëposhtme: këshilli duhet t'i caktojë këtij të diplomuari të ri pozicionet. Ata mund t'i caktojnë në ato pozicione që janë të hapura, në atë periudhë kohe të caktuar. Nëse ka më shumë magjistarët, të cilët kanë mbaruar se sa vendet vakante, atëherë këshilli duhet t'i caktojë ata në pozicione të komanduara, që do të thotë brenda Këshillit të Lartë të Drejtësisë, brenda Inspektoratit ose brenda Ministrisë së Drejtësisë. Këta magjistratë mund të komandohen, me qëllim që ata të shërbejnë atje deri sa të hapet një vend i caktuar. Pra, kjo gjë sigurohet, që secili i diplomuar të caktohet menjëherë, të emërohet menjëherë dhe menjëherë atij t'i caktohet një pozicion brenda sistemit.

**Fatmir Xhafaj** - Neni 41.

Urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Çfarë kuptimi ka në ligj “termi dy herë verifikimi i pasurisë”? E ka verifikuar kur ka hyrë dhe ka kaluar sërish verifikimi i pasurisë dhe i figurës. Mbi çfarë kriteresh ecim? Ky verifikimi i pasurisë në fillim të shkollës, pas mbarimit të shkollës, kur të shkojë atje përsëri verifikim i pasurisë. Ka një deklaram pasurie dhe më pas ka verifikimin ciklik siç e ka ligji. Çfarë do të thotë që mbaroj Shkollën e Magjistraturës dhe t’i verifikohet sërish pasuria? Këtu shkojmë deri në manikaliteti. Çfarë kuptimi ka? Ky ka detyrim të deklarojë pasurinë dhe më pas të bëjë deklaramet, siç i ka ligji, me cikle të caktuar një herë në vit. Pse duhet të bëjmë këto lloj gjërash? Ne nuk vuajmë nga manikaliteti që kemi të bëjmë me maskarenj, të cilët vjedhin dhe duhet t’i verifikojmë vazhdimisht se ndoshta i zëmë. Flas në përgjithësi që duhet të kemi dhe një minimum respekt për integritetin e këtyre njerëzve. Në rast se ky ka bërë probleme me pasurinë që në momentin e parë, atëherë ky është i përjashtuar si kandidatë dhe nuk mund të hyj.

Së dyti, ka diçka, dhe kjo është pa ndonjë vlerë, një kandidat “kërkon të emërohet”, unë jam i mendimit që “mund të kërkojë të emërohet”, nuk mund të thotë kërkon, pasi pika 4 thotë: “Këshilli edhe mund ta pranojë, por edhe mund të mos e pranojë një person nga lista e të diplomuarve”. Kështu që ideja kërkon është një mundësi, pra mund të kërkojë, ligji e hap këtë mundësim, kurse “kërkon” është një gjë afirmative dhe po qe afermative e merr.

Pika 4 e ka rrëzuar këtë gjë, pasi thotë ose përmbush kriteret, ose publikon njoftimin për mos pranimin në rast se nuk i përmbush kriteret.

Kështu që në këtë pikë këto dy vërejtjet kisha. Edhe për germën “c” të pikës së parë edhe më pas për këto korrektimet, që janë absolutisht minimale për pikat e tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Në fakt, lidhur me shqetësimin që ngriti zoti Vasili, dua të theksoj se ...

**Fatmir Xhafaj** – Se kjo fjala “sërish” ka të drejtë, i ka kaluar sërish verifikimit. Çfarë?

**Vasilika Hysi** – Në nenin 37 të ligjit, që sapo kaluam, asnjë kandidat për magjistratë nuk mund të kandidojë nëse nuk verifikohen burimet e financimit të pasurisë dhe asetet, sepse mund të ndodhë që ai ka aq shumë pasuri, sa nuk justifikon. Kjo është në pranim. Tani kalojnë 3 vjet, gjatë 3 vjetëve ai nuk deklaron pasuri, sepse nuk është funksionar. Pas 3 vjetësh, ku brenda këtyre 3 vjetëve një vit e ka bërë praktikë profesionale në gjykatë apo në prokurori, është e logjikshme që kur ai të marrë emërimin dhe të fillojë punë të deklarojë. Secili që fillon një punë deklaron në fillim të punës së tij...

**Fatmir Xhafaj** – Ai e ka detyrim që kur hyn në Shkollën e Magjistraturës dhe e paguan shteti, vit për vit duhet të bëjë deklarinimin.

**Vasilika Hysi** – Jo, vetëm një deklarinim ka, kur pranohet në shkollë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, le t'i bëjë viti për vit, siç bëjnë gjithë të tjetër. Pse duhet të bëjë një rishikim pas 3 vjetësh?

**Vasilika Hysi** – Në rast se ju jeni për bërë një verifikim të çdo viti, në vit të parë.

**Fatmir Xhafaj** – Siç ndodh me të gjithë që bëjnë deklaratë.

**Vasilika Hysi** – Ai në vit të parë dhe të dytë është student.

**Fatmir Xhafaj** – Vasilika nuk është kështu. Ai është student, që paguhet nga shteti dhe duhet të bëjë deklarinimin e pasurisë çdo vit.

**Petrit Vasili** – Në qoftë student, Vasilika, qëndroi logjikës së ligjit, studenti nuk deklaron pasuri.

**Vasilika Hysi** – Nuk deklaron.

**Petrit Vasili** – Po ky ka deklaruar kur ka hyrë, vetë e ke thënë këtë gjë: ose rrijë të parës, ose të dytës.

**Vasilika Hysi** – Atëherë, janë dy opsione: opsioni parë është që të verifikohet pasuria çdo vit.

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra te neni 37 “verifikohet pasuria dhe i nënshtrohet deklarinimit të pasurisë gjatë gjithë kohës.

**Vasilika Hysi** – Para se të fillojë të marrë detyrën, ai bën deklaratën në fillim të detyrës, siç e bëjmë të gjithë ne. Ashtu sikurse kur e lë një detyrë dhe fillon një pozicion tjetër, përsëri...

**Fatmir Xhafaj** – Vasilika, që ku ka hyrë në Shkollën e Magjistraturës, e ka bërë këtë gjë.

**Vasilika Hysi** – Megjithatë, ja ku janë dy opsione, ose të deklarojë çdo vit (dhe kjo kërkon ndryshim te neni 37), ose do të lëmë një verifikim të pasurisë përpara se të pranohet dhe të emërohet.

**Fatmir Xhafaj** – Ai kontrollohet pastaj herë pas here dhe bëhet si të gjithë nëpunësit e tjerë të shtetit, sepse e ka detyrim.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me pikën 3 që tha zoti Vasili, pra pse është përdorur folja “kërkon”, në fakt këtu flitet për formën shkresore, pra do të kërkojë me shkrim apo me gojë.

Këtu thuhet: "...kërkon me shkresë drejtuar këshillit që të emërohet", pra bën një kërkesë për t'u emëruar.

**Fatmir Xhafaj** – Mund të kërkojë, sepse mund të mos dojë ai të emërohet.

**Vasilika Hysi** – Në qoftë se do të dojë, do ta bëjë me shkresë...

**Fatmir Xhafaj** – "Mund të kërkojë", tha ai.

**Vasilika Hysi** – Por jo me shkrim, sepse flitet për formën si do ta bëjë kërkesën.

**Petrit Vasili** – Fatmir, po bëj një pyetje për sqarim: këto sqarimet mund t'i bëjnë ata që e kanë hartuar këtë, pse i bën Vasilika?! Nuk po e kuptoj këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Vasilika është relatores...

**Petrit Vasili** – Është tjetër gjë qasja si relatores dhe tjetër gjë qasja për çdo vërejtje.

**Fatmir Xhafaj** – Biem dakord me të dyja ndryshimet që u propozuan.

Neni 41 "Emërimi i ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve magjistratë".

**Vasilika Hysi** – Ky është një nen i cili u jep mundësi ish-gjyqtarëve dhe prokurorëve, që kanë një formim të rikthehen në sistem, por duke plotësuar disa kushte, të cilat janë të përcaktuar më se qartë. Një nga pikat e diskutueshme është afati i përcaktuar në gremën "b" të pikës 2 të këtij ligji, ku thuhet: "Personi që ka qenë gjyqtar apo prokuror, që të rikthehet në sistem, duhet të jetë i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe në 10 vjetët e fundit të ketë ushtuar për 5 vjet funksionin e magjistratit". Unë kam një pyetje për ekspertët: Shkolla e Magjistraturës e ka diplomuar brezin e parë në vitin 2000 dhe nga viti 2000 deri më sot kanë dalë disa breza. Dhënia e mundësisë vetëm atyre që kanë mbaruar 10 vjetët e fundit dhe jo 15 vjetët e fundit dhe kushti i dytë që të kenë 5 vjet magjistratë, për mendimin tim, mund të krijojnë një pabarazi ndërmjet njerëzve, sepse të gjithë mund të thonë se janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, pra nuk kanë mbaruar në vitin 2006, por në vitin 2003 dhe nga 2003 në vitin 2006 kurrikula e shkollës nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Ne lëmë jashtë të drejtës për të kandiduar, për të rikthyer, një kategori të caktuar njerëzish, ndërkohë që ne mund të kemi nevojë, në qoftë se ata kalojnë procesin e vetingut, në qoftë se ata kanë një vlerësim të etikës, mund ta lëmë hapësirën për t'u dhënë mundësi këtyre personave që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës pa bërë diferencim, pra 10, 11 apo 12 vjet. Unë sugjeroj të gjithë ata që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës në këta 15 vjet, pra që kur ka dalë brezi i parë i të diplomuarve, dhe që kanë ushtruar funksionin e magjistratit. Kjo pyetje ishte për ekspertët.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Mendoj se ka pasur arsye për të diskutuar nëse afati kohor i 10 vjetëve është shumë i ulët. Mbase mund ta ngremë atë deri në 15, por unë do të hezitoja këtu t'i referohesha vetëm diplomimit nga Shkolla e Magjistraturës, sepse me kalimin e kohës, me kalimin e viteve, atëherë ju do të keni situata, ku gjyqtarët që kanë mbaruar shkollën 14 vjet më parë, ose kanë ushtuar detyrën 30 vjet më parë si gjyqtarë dhe ata duan të rikthehen përsëri brenda sistemit. Ideja brenda kësaj ka qenë se përvoja si magjistratë nuk duhet të jetë shumë përpara në kohë. Nëse ne mund të biem dakord me këtë situatë, ku ta çojmë në 15 vjet për Shkollën e Magjistraturës, por përsëri të mbajmë një periudhë kohë kur këta magjistratë kanë kryer përvojën e punës, pra le të themi një përvojë të arsyeshme pune, të mos kthehemi shumë mbrapa në kohë.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe ti që pyet, edhe ajo zonja që përgjigjet: kjo është një dispozitë hipotetike, se nuk ka asnjë rast. Kjo është se çfarë do të ndodhë pas 15-20 vjetësh, kur të çlirohet Shqipëria nga korrupsioni! Të mos i hyjmë kësaj se çfarë do të bëhet pas 10 vjetësh. Këto janë dispozita...

**Vasilika Hysi** – Besoj se nuk duhet të ketë. Tek-tuk do të jetë ndonjë...

Lidhur me nenin 41, kam disa riformulime të teknikës legislative, sipas tabelës bashkëngjitur. Është betimi...

**Fatmir Xhafaj** – A keni ndonjë gjë për mënyrën si betohemi, pra që i shërbejmë Republikës dhe i qëndrojmë besnik Kushtetutës? Jo, nuk ka.

Po këtë betimin e gjyqtarëve të sapoemëruar me një ceremoni publike, e organizuar nga secili këshill përkatës! Po sikur kjo të jetë një gjë që nuk bëhet para këshillit, sepse bëhesh gjyqtar dhe prokuror i Republikës... Këta kanë një... Të paktën, ta lëmë Presidenti i Republikës...

**Vasilika Hysi** – Në fakt, zoti kryetar, këtu thuhet: “Ceremoni publike që organizon Këshilli i Lartë i Gjyqësorit ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas studentëve”. Lidhur me formën, mund të flasim ekspertët.

**Fatmir Xhafaj** – Nejse, shikojeni! Unë e di që kështu është sot. Nëse është kështu, ta ruajmë.

Neni 43 “Dosja personale dhe regjistri i magjistratëve”.

**Vasilika Hysi** – Nuk ka absolutisht asgjë, madje e vlerësoj që ka një transparencë të gjithë dokumentacionit që të paktën duhet të ketë një dosje, meqenëse krijohet edhe regjistri i

magjistratëve nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pra, duhet të ketë një unifikim të dokumentacionit për të gjithë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 44.

**Vasilika Hysi** – Neni 44 bën fjalë për caktimin në pozicion të magjistratëve të sapoemëruar. Këtu ka nevojë për ndonjë redaktim, siç e shikoni, në kolonën tretë të tabelës të problemeve gjuhësore. Pra, nuk ka ndonjë problem tjetër thelbësor.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me riformatimin.

Neni 45.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 45 bëhet fjalë për caktimin e përkohshëm në pozicione e të komanduarve të rinj. Është një risi në ligj, pra për herë të parë persona, të cilët nuk kanë një pozicion pune, mund të komandohen në pozicione të caktuara të nxjerra nga këshillat përkatëse, ku marrin listën, bëjnë shpalljen publike të vendeve të lira e të tjera.

Lidhur me këtë nen, doja një saktësim nga ekspertët nëse do të përdorim termin “pozicion i komanduar”, sepse herë përdoret fjalët “pozicion i komanduar”, herë fjala “komandim”, një herë thuhet “emërim”, “caktim i përkohshëm në pozicionin e komanduar”. Pra, meqenëse është një institut i ri, të cilin nuk e kemi pasur më parë, do të ishte më mirë që të kishim një terminologji të qartë.

Lidhur germën “b” të pikës dy, ku thuhet “i emëruari i komanduar mund të punojë në shërbime të tjera”, fjalët “shërbime të tjera” duhet të jenë saktësuar. Në qoftë se ureferohemi përkufizimeve, shërbime të tjera janë shërbimet që bëhen pranë Ministrisë së Drejtësisë, pranë misionëve ndërkombëtare ose shërbime të tjera, të cilat nuk janë gjyqtarë dhe prokurorë. Kjo duhet saktësuar për të krijuar idenë e qartë që nuk bëhet fjalë për shërbime, të cilat nuk lidhen me profesionin.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Agnes!

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Pas kësaj, është ideja për t’i caktuar në komisione të komanduara. Në fakt, duhet qartësuar në tekst.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe ju bini dakord për ta qartësuar.

Atëherë, duhet riformualuar.

Faleminderit!

Neni 46 “Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit”.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me këtë nen, nuk kam ndonjë problem. Vetëm germa “b” e pikës 3 kërkon një riformulim lidhur me dispozitën. Pra, janë vetëm folje të teknikës legislative, presje, por duhet bërë lidhja e pjesëve të fjalisë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Vazhdojmë me nenin 47 “Parimet e transferimit”.

**Vasilika Hysi** – Është një institut shumë i rëndësishëm dhe është për t’u vlerësuar që në ligj për herë të parë përcaktohen parimet të qarta, transparente sesi mund të transferohet një magjistrat, mbi të gjitha, parimi që magjistrati nuk mund të transferohet pa pëlqimin e tij.

Njëkohësisht, këtu kam parashtruar disa sugjerime për të bërë riformulimin e paragrafëve të veçantë të kësaj pjesë. Unë kam një pyetje për ekspertet lidhur me paragrafin ose me pikën 3, ku thuhet: “Magjistrati gëzon të drejtën të marrë pagë më të lartë gjatë periudhës së transferimit, kur pozicioni në të cilin magjistrati është transferuar parashikon pagë më të lartë”, çfarë do të ndodhte nëse magjistrati, qoftë gjyqtar apo prokuror, do të transferohej në një prokurori ose në një gjykatë me një pagë më të ulët, cilën pagë do të merrte, atë që kishte para transferimit apo pagën e dytë?

**Fatmir Xhafaj** – E thotë qartë, pagën e paratransferimit; e ka vetë kuptimi i nenit.

**Vasilika Hysi** – Unë doja ta saktësoja këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Po, ekspertët.

**Agnes Bernhard** – Nëse transferohet në një pozicion me një pagesë më të ulët, ai do të marrë pagesën e mëparshme, pagën që ishte më e lartë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Petrit Vasili** – Ky formulimi në shqip është vërtet shumë i çuditshëm. “Magjistrati gëzon të drejtën për të marrë pagë më të lartë gjatë periudhës së transferimit, kur pozicioni në të cilin magjistrati është transferuar parashikon pagë më të lartë”. Çfarë do të thotë kjo?! Sigurisht që pagën më të lartë do të marrë. Duhet të thuhet “parashikon pagë më të ulët”. Ky nen është një lajthitje. Duhet të korrigjohet.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet “më të ulët”. E pranoi që ishte gabim. Kur parashikon pagën më të ulët, do të marrë pagë më të lartë.

Jemi dakord me ndryshimin.

Neni 48 “Procedura e lëvizjes paralele”.



**Vasilika Hysi** – Lidhur me procedurën e lëvizjes paralele, ka thjesht një nevojë për riformulim nga pikëpamja e teknikës legislative. Ne e kemi bërë një riformulim në shtyllën e tretë dhe unë do të kërkoj opinionin e EURALIUS-it nëse riformulimi që u kemi bërë pikave 1 dhe 2 të këtij ligji, po ashtu edhe formulimet e bëra në pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 janë konform asaj çfarë kanë pasur në konsideratë ekspertët e nivelit të lartë, pasi ky nen është riformuluar nga pikëpamja e teknikës legislative pothuajse plotësisht. Ndoshta mund t’u lëmë kohë.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Duhet të reflektojmë për këtë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 49 “Transferimi pa pëlqim”.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, është risi që magjistratët nuk mund të transferohen pa pëlqimin e tyre dhe përcaktohet detyrimi që atyre t’u jepet mundësia për të marrë një pozicion të caktuar. Unë kisha një pyetje, por e qartësova edhe me zonjën Agnese, se çfarë do të bëhet me një magjistrat, kur ai punon në një gjykatë, e cila në bazë të akteve gjyqësore, mund të mbyllet, vendi i tij mund të shkurtohet dhe do të hyjë në radhë për pozicionin e ri. Kush do të ketë prioritet? E bëra këtë pyetje, pasi nga leximi i nenit 49, në germet “b” dhe “c” kjo gjë nuk ishte shumë e qartë. Zonja Agnes thekson se për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative, qoftë edhe në kompetencat tokësore, por ndonjëherë edhe lëndore, fjala suprimim, e zgjidh këtë problem. Nuk e di se sa saktë dhe qartë e kemi kuptuar.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Dakord.

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, në këtë kuadër, do të donim që misioni Euralius dhe ekspertët e nivelit të lartë të vlerësonin riformulimin që i është bërë pikës dy për të parë nëse riformulimi është i saktë apo jo?

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Do ta shikojmë këtë gjë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord. Neni 50, “Magjistratët në skemën e delegimit”.

**Vasilika Hysi** - Është një skemë e re, ku thuhet që magjistratët në të gjitha shkallët mund të aplikojnë për pozicione në skemën e delegimit, pra nëse magjistrati nuk është në një pozicion të caktuar delegimi, por është i lirë! Në paragrafin e katërt të këtij neni, thuhet se për aq kohë që magjistrati është në pritje për të përfutur nga skema e delegimit, ai shërben në strukturat e administratës së këshillave.

Pyetja ime është praktike. Në rast se numri i magjistratëve në skemën e delegimit nuk është një apo dy, por disi i lartë, dhe këshillat detyrohen që t’u punësojnë ata, praktikisht, a ekziston mundësia që këshillat t’i ofrojnë punë magjistratëve, që janë në skemën e delegimit?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Ideja është që paragrafi i katërt garanton që magjistratët, të cilët përcaktohen në këto pozicione në gjykata të caktuara, në fazën e ndërmjetme nuk punojnë, por paguhen dhe të paktën duhet që të ofrojnë një shërbim për këshillin. Ndoshta duhet të jetë detyrim i këshillit për të vlerësuar numrin e magjistratëve të nevojshëm në skemën e delegimit, për të mos pasur një numër shumë të lartë, por një numër i cili është i nevojshëm për sistemin.

**Vasilika Hysi** – Pyetja tjetër ka të bëjë me faktin nëse ky sistem delegimi funksionon si për gjyqtarët ashtu edhe për prokurorët, apo vetëm për gjyqtarët?

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Supozohet që funksionon si për gjyqtarët, ashtu edhe për prokurorët.

**Vasilika Hysi** - Pyetja tjetër lidhet me parashikimin që ju keni bërë në paragrafin e pestë. Në paragrafin e pestë jepet mundësia që kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, t'i kërkojë këshillit të caktojë përkohësisht një magjistrat për të gjykuar dhe hetuar një çështje të caktuar ose kategori çështjesh. Në gjykimin tuaj, a e dëmton transparencën dhe objektivitetin e hetimit caktimi i një gjyqtari konkret pa short për një çështje konkrete, ndërkohë që për të gjitha hetimet dhe gjykimet e tjera shpërndarja e çështjeve do të jetë me short?

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Mendoj se varet nga mënyra se si e organizoni këtë gjë, por raporti pas këtij përcaktimi është që në një gjykatë, për shembull, mund të ketë një numër shumë të lartë të çështjeve të caktuara që dalin papritur, të cilat vijnë nga situata të caktuara që dalin në një rajon, si për shembull një aksident i një niveli shumë të lartë dhe këto situata të papritura mund të na çojnë në çështje të paparashikuara. Pra, do të na duhet që të përcaktojmë një gjykatës për këtë çështje dhe patjetër që duhet një kriter objektiv dhe transparent për të përcaktuar gjykatësin dhe kjo nuk e prish kriterin për dhënien e një çështjeje një gjykatësi të caktuar, por për të shmangur ndonjë dykuptueshëri, ndoshta duhet të përfshijmë këtu edhe parimin për përcaktimin e çështjeve në mënyrë transparente dhe objektive.

**Vasilika Hysi** - Kam një pyetje lidhur me paragrafin e gjashtë të po këtij neni. Në paragrafin e gjashtë të këtij neni parashikohet, se në rast një magjistrat ka shërbyer për të paktën katër vjet në skemën e delegimit, dhe të paktën gjashtë muaj në një pozicion të nivelit të apelit, ai mund të marrë emërim dhe të plotësojë vakancën që krijohet në Gjykatën e Apelit. Nuk e di se çfarë mendojnë kolegët, por unë jam kundër, sepse ne kemi folur kaq shumë vite për promovim të gjyqtarëve dhe prokurorëve jo në bazë të meritokracisë dhe të kalimit shkallë pas shkalle nga

një gjykatë në një tjetër. Të punosh katër vjet në skemën e delegimit, dhe vetëm gjashtë muaj në Gjykatën e Apelit, pastaj pa kaluar hierarkinë dhe fazat, të bëhesh menjëherë gjyqtar apo prokuror apeli, mua më duket se mund të jetë abuzive. Në parim, gjashtë muaj nuk tregojnë se je i aftë për të kaluar në një shkallë gjykimi më të lartë, por mund të keqpërdoret nga këshillat që dikush të jetë gjatë gjithë kohës në skemën e delegimit, për katër vjet, dhe të punojë gjashtë muaj në një gjykatë apo prokurori apeli dhe në krye të gjashtë muajve ai të bëhet prokurori gjyqtar. Unë sugjeroj se përvoja duhet të jetë më e lartë për në një pozicion të nivelit të apelit.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, por pse është e nevojshme kjo? Të mos e zgjasim, sepse s'kemi pse të bëjmë përsëritje. Të na e shpjegojë nevojën dhe po të më pyesësh, edhe unë jam me idenë tuaj, por mbase ata kanë një argument më të fortë. Po.

**Agnes Benhard** - (*flet anglisht*) Nga njëra anë ideja është për t'i dhënë disa stimuj gjyqtarëve, me qëllim që ata të përfshihen brenda skemës së delegimit, dhe nga ana tjetër, gjyqtarët të cilët janë brenda skemës së delegimit që janë mjaft fleksibël, brenda një periudhe kohe të shkurtër mund të marrin përvoja nga gjykata të ndryshme në nivele të ndryshme, në fusha të ndryshme, gjithashtu ata kanë edhe sfidën që të përshtaten vazhdimisht ndaj çështjeve dhe mjediseve të ndryshme.

Kështu që ka dy elemente, por me qëllim që t'i përgjigjem edhe shqetësimit tënd, ne mund ta rrisim këtë kohe nga gjashtë muaj me të paktën dy vjet dhe për të parashikuar më tej se këta gjyqtarë duhet të kenë të paktën përvojën minimale para se ata të emërohen në një nivel të lartë siç është ai i apelit.

**Fatmir Xhafaj** - ..., sepse në një kohë të caktuar ka shërbyer në delegim për... Ai për atë është paguar, por praktika e delegimit njihet edhe sot, e cila nuk ka krijuar ndonjë shqetësim dhe për më tepër që me ligjin e ri krijohet një skemë më e plotë. Dakord me ndryshimet e propozuara.

**Vasilika Hysi** – Ndërkohë, ky nen ka disa saktësime të vogla termash.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, e thamë atë.

**Vasilika Hysi** - Neni 51, “Transferimi i përkohshëm...

Në fakt, unë kam një pyetje lidhur me nenin 51, që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm. Këtu përdoren dy terma, skema e delegimit dhe skema e mobilitetit, por janë e njëjta gjë apo janë të ndryshme dhe nëse janë të ndryshme, cili është dallimi?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Ne e bëjmë dallimin ndërmjet atyre gjyqtarëve të cilët janë pjesë e skemës së delegimit dhe atyre që kanë nënshkruar kontratën për t’u transferuar atje ku ata kanë nevojë.

Nga ana tjetër, ne nuk mund të jemi të sigurt që ka gjyqtarë të mjaftueshëm brenda skemës së delegimit dhe nëse ata janë pjesë e kësaj skeme. Për këtë arsye ne duhet të sigurohemi se ka numër të mjaftueshëm brenda skemës së delegimit dhe nëse nuk ka gjyqtarë të mjaftueshëm, në rast se është e nevojshme ne mund t’i transferojmë gjyqtarët përkohësisht. Në këtë grup të dytë çështjesh apo rasti, për një transferim të përkohshëm, kjo rregullohet me nenin 51.

**Gent Ibrahim** – Është i njëjti koncept, por janë përdorur dy terma, kështu që në paragrafin e parë fjala “mobilitet” duhet të zëvendësohet me fjalën “delegim”.

**Fatmir Xhafaj** – Në skemën e delegimit

**Vasilika Hysi** - Është e njëjta gjë.

**Fatmir Xhafaj** - I pastroni të gjitha këto, sepse duke punuar edhe anglisht edhe shqip, është krijuar...

**Etilda Gjonaj**- Për emrin, meqenëse ishte një institut i ri, ka pasur diskutime edhe gjatë grupit të punës, ku fillimisht e quajtëm “skemë mobiliteti”, dhe pastaj me **dëshirën** për ta shqipëruar sa më shumë e lamë delegimi, por është delegim.

**Fatmir Xhafaj** - Sepse duan të heqin emrin jo të mirë që ka sistemi i delegimit sot, dhe në fakt, kanë pasur të drejtë.

**Etilda Gjonaj**– Kjo ka qenë arsyeja, dhe ka pasur shumë debate edhe gjatë...

**Fatmir Xhafaj** - Më mirë të ndryshojmë praktikën se sa emrin, mobilitet, delegim.

**Etilda Gjonaj**– Po.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord.

**Vasilika Hysi** - Zoti Kryetar, cili do të jetë emërtimi, sepse unë nuk e kam?

**Fatmir Xhafaj** - Delegim thatë, apo...

**Vasilika Hysi** - Skema e delegimit?

**Fatmir Xhafaj** - Po.

**Vasilika Hysi** - Gjithashtu, do të doja nga grupi i ekspertëve që të shikonin riformulimin që i kemi bërë paragrafit të dytë të këtij neni, nëse e kemi riformuluar qartë dhe saktë.

Kam një pyetje lidhur me paragrafin e dytë. Ju thoni që për të transferuar përkohësisht në një pozicion një magjistrat duhet marrë mendimi i kryetarit të gjykatës apo i prokurorisë përkatëse. Në rast se mendimi i tyre është negativ, pra, nuk pranon ta delegojë, a mundet këshilli përsëri ta bëjë lëvizjen, delegimin e këtyre personave? Pra, marrja e mendimit është e detyrueshme apo është thjesht këshilluese?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Është një detyrim që të merret ky mendim, por vetë mendimi nuk është i detyrueshëm. Pra, është një mendim jo i detyrueshëm. Duhet të kërkosh për mendimin, por vetë mendimi nuk është i detyrueshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Në qoftë se nuk është i detyrueshëm, pse duhet marrë mendimi i kryetarit të gjykatës dhe i prokurorisë përkatëse? Dhe kur flasim për mendim të kryetarit të gjykatës bëhet fjalë për kryetarin e prokurorisë dhe gjykatës ku do të shkojë personi, apo atje ku është? Ta sqaroj pak, sepse kërkohet riformulim i diskutimit.

**Fatmir Xhafaj** – Atje ku është, se do t'i thuash titullarit që nëse mund ta lëvizë këtë, apo ka ngarkesë, apo çështje.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Po, flasim për kryetarin ku magjistrati tashmë është duke punuar, sepse ti ke nevojë për të njohur situatën e institucionit ku ai punon. Nëse ky magjistrat do të mungojë për 6 muaj në këtë institucion sigurisht gjykata do të vazhdojë të jetë në funksion.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Në dispozitë nuk rezulton kaq e qartë prandaj kemi bërë një riformulim të pikës 2 dhe të pikës 4 të këtij neni. Gjërat e tjetra pastaj janë gjëra të vogla shtypshkrimi.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Miratohet neni 51 me ndryshimet që u thanë.

Neni 52. Ngritja në detyrë.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me ngritjen në detyrë unë kam dy- tri pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me paragrafin e parë. Në paragrafin e parë thuhet që magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson disa kritere minimale dhe midis kriteve është që të ketë shërbyer edhe në shërbimin e inspektimit. Kur themi në shërbimin e inspektimit, bëhet fjalë në inspektimin e përgjithshëm apo në fusha specifike?

Duhet të jetë 5 vjet si inspektor apo 5 vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë penale? Kur themi shërbim në inspektim kemi parasysh inspektimin në Ministrinë e Drejtësisë apo Inspektoratin e Drejtësisë?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në të ardhmen do të ketë vetëm Inspektorat i Lartë i Drejtësisë. Për momentin kemi disa shërbime inspektimi dhe ideja këtu është që në përgjithësi ata duhet të kenë nevojë për këto 5 vjet ose në fushën e drejtësisë penale ose në fushën e shërbimit të inspektimit.

Në fushën e shërbimit të inspektimit puna që ai duhet të bëjë ka natyrë hetuese dhe duhet të jetë më shumë afër përvojës që duhet të ketë në të drejtën penale.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, kam një pyetje tjetër. Një person që ka shërbyer si inspektor në Ministrinë e Drejtësisë ose në inspektorat a mund të kalojë direkt në Gjykatën e Apelit vetëm me faktin që ka punuar 5 vjet si inspektor?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Jo, duhet të ketë 10 vjet të paktën dhe nga këto 10 vjet ai duhet të ketë 5 vjet eksperiencë në fushën penale ose në fushën e inspektimit.

**Fatmir Xhafaj** – Pyetja është: Përse duhet të jetë kjo përvoja në fushën e inspektimit? Po i bëjmë gjyqtarë dhe prokurorë apo po i bëjmë kryetar gjykatash?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Janë thjesht gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët janë promovuar në këtë skemë antikorrupsion dhe inspektorët referohen aty, sepse eksperiencia e tyre është e lidhur ngushtë me fushën penale të drejtësisë penale.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, inspektori që është sot në Prokurori të Përgjithshme, që është për inspektimin e prokurorive me eksperiencën e tij në fushën penale.

A mund të ma bëni këtë lidhje? Zakonisht në shërbimet e inspektimit që janë sot, janë inspektorët më të paaftë, pak a shumë. Caktojnë ata që nuk i ka me shumë dëshirë ose që nuk duan të bëjnë asgjë prokurorët e Përgjithshëm, për shkak se kështu ka funksionuar sistemi. Tani i themi që meqenëse ke qenë 5 vjet në inspektim, shko bëhu dhe prokuror i prokurorisë së posaçme. Nuk rrinë bashkë këto. Ndërkohë që mund të ketë mbetur prapa edhe nga pikëpamja e nivelit profesional.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* E kuptoj atë çfarë doni të thoni. Po i referoheni situatës aktuale, por raporti pas kësaj është se idetë për të tërhequr njerëz shumë të mirë është synimi për të tërhequr njerëz shumë të mirë në funksionet inspektuese. Ata duhet të jenë të aftë

të pastrojnë sistemin. Pra, na duhen inspektorë të fuqishëm dhe me aftësi të forta në të ardhmen në këtë sistem inspektimi.

Pra, ndoshta këtu mund të kemi një parashikim transitor ose mund të themi që shërbimet e inspektimi janë inspektorët e lartë për të shmangur situatat aktuale me jo shumë kualifikime.

**Pandeli Majko** - E fundit që tha Anges që le ta bëjmë këtë dispozitë të veprorë në të ardhmen, nënkupton se Inspektorati i Lartë i Drejtësisë mund të ketë vështirësi për të rekrutuar gjyqtarë dhe prokurorë atje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Besoj se u kuptuam që të mos vazhdojmë me detaje.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, për sqarimet! Gjithashtu, kam një pyetje për paragrafin e dytë.

Në paragrafin e dytë ne themi që për të gjitha këto pozicione të promovimit personat duhet të përmbushin kritere të tilla, siç është kushtet e sigurisë procesi i verifikimit të figurës, heqjes dorë nga privatësia. Por pasuria ka shpëtuar apo nuk e keni...? Mendoj që duhet të jetë pjesë, sepse është pjesë e vetingut edhe vlerësimi i pasurisë. Pra, mungon njëri nga tre komponentët e rivlerësimit të tyre.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Këto janë vetëm kriteret e përgjithshme. Promovimi për secilin pozicion ka patjetër edhe një kontroll tjetër. Pra, kemi edhe një kriter shtesë dhe gjatë procesit të promovimit kontrolli dhe deklarimi i pasurive patjetër që përcaktohet dhe gjendet aty.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, kam një pyetje për ekspertët që kanë punuar për ligjin “Për prokurorinë” dhe ndoshta për kolegun që është relator. Ky lloj formulimi që është bërë për rekrutimin e inspektorëve dhe të magistratëve në Gjykatën e Shkallës së Dytë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por edhe në prokurori, a është e njëjtë me ligjin tjetër që ne kemi filluar tashmë nga diskutimi dhe njëkohësisht për emërtimin?

Përfundimisht, është lënë ose do ta lëmë gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pasi përdoren terminologji të ndryshme.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Ka pasur takime të koordinuara me grupet e punës, me prokuroritë, ku jemi përpjekur të sigurojmë një shtrirje paralele të këtij parashikimi. Gjithashtu, kemi pasur edhe një grup pune për strukturat e antikorrupsionit. Kështu të paktën në

këtë takim tekstet përputheshin, por gjatë procedurave nëse ndryshon diçka këtu-aty, do të na duhet edhe një kontroll përfundimtar për të bërë unifikimin.

**Pandeli Majko** – Prokuroria është në Kushtetutë në fakt dhe me sa po shikoj tani ashtu është te prokuroria e posaçme.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë këtë e ngrita, sepse në tekst ka emërtime të ndryshme.

Lidhur me paragrafin e tretë kam një pyetje. Ju kërkoni, parashikoni që magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave dhe prokurorive të shkallës së dytë nëse ka ushtruar një periudhë të caktuar kohe në një fushë të së drejtës.

Për gjyqtarët, magjistratët këtë e kuptoj, sepse mund të kesh civilist, penalist, por për prokurorët cila është fusha e së drejtës? Sepse në fushat e së drejtës për prokurorët mendoj që është fusha e vetme. Këtu ju më poshtë thoni që në për të paktën 5 vjet në fushën e të drejtës përkatëse të vlefshme për pozicionon.

Pra, a duhet të jetë ky kriter edhe për prokurorin? Nëse jo duhet ta riformulojmë që të qartësojmë që fushat e së drejtës janë më të larmishme për gjyqtarët, por për prokurorin është më specifike. Është fusha penale.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Sigurisht që prokurorët gjithmonë do të kenë 5-vjeçarin e nevojshëm, sepse ata punojnë në këtë fushë, por një gjykatës, i cili nuk ka punuar kurrë ose ka punuar shumë pak në fushën civile, nuk duhet të promovohet në një pozicion në një Gjykatë Apeli në seksionin e ligjit civil për shembull. Kështu që të sigurohemi të garantojmë specializimin e gjykatësve.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Kam edhe një pyetje tjetër. Ju keni përcaktuar një kriter që një magjistratë me 7 vjet punë përvoje, mund të bëhet kryetar i gjykatës ose i prokurorisë së Apelit.

A ju duket i mjaftueshëm afati 7-vjeçar për të çuar një magjistrat drejtues në funksionin drejtuesit të gjykatës ose të Apelit, duke pasur parasysh kompetencat që ka?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Në fakt e kemi rritur këtë periudhë kohore, sepse tani mendojmë se është 5 vjet. Sigurisht që mund të diskutohet që në nivelin e apelit të kërkohet një eksperiencë edhe më e madhe se kjo. Pra, jemi të hapur ndaj një propozimi të tillë.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë do të bëja një sugjerim. Meqenëse në këtë paragraf rregullohet ngritja në pozicion për kryetarin e Gjykatës dhe të Prokurorisë të Shkallës së Parë



dhe të Dytë nuk mund të ketë të njëjtat kritere për vjetërsi. Si ai që do të bëhet kryetar i Gjykatës dhe i Prokurorisë së Shkallës së Parë me atë që bëhet kryetar ose kryetar i Prokurorisë në Shkallë të Dytë. Të paktën një diferencim kohor do të ishte e përshtatshme.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Sapo m'u kujtua që kemi një diferencë këtu në aspektin kohor, sepse nëse shikoni te vitet, tek eksperiencia që duhet të kenë për t'u promovuar në nivelin e apelit, është 7 vjet.

Paragrafi i pestë kërkon, gjithashtu, që gjykatësit duhet të kenë të paktën 4 vjet në nivelin respektiv, që do të thotë për gjykatësit e Apelit të paktën duhet 11 vjet dhe kjo mendoj se është e duhur për situatën. 11 vjet si gjyqtar dhe të paktën 4 vjet në nivelin e apelit. Pastaj mund të bëhet kryetar i gjykatës të një niveli të apelit.

**Vasilika Hysi** – Mënyra si po e thoni më pëlqen, që ka një diferencim, por në germën “a” të paragrafit 5 të këtij neni thuhet “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë nëse ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se 7 vjet, nga të cilat jo më pak se 4 në të njëjtën shkallë.”

**Fatmir Xhafaj** – Po, pra, po thotë bëj një diferencim nga shkalla e parë në apel. Rishkruajeni dhe ta bëni këtë diferencim. Ky është kuptimi.

**Vasilika Hysi** – Vlerësoj faktin që keni deklaruar papajtueshmërinë që një anëtar i këshillit dhe i KLD-së. Kjo është një risi që nuk ka të drejtë edhe pasi mbaron afatin të kërkojë ngritjen në detyrë. Kjo është një hap shumë pozitiv të cilin ne e kemi pasur problem dhe është zgjidhur më së miri.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 52 me riformulimin dhe me ndryshimet e sugjeruara për t'u rivlerësuar? Dakord.

Neni 53. Ngritja në detyrë në shkallë më të lartë ose të specializuar.

**Vasilika Hysi** – Një nga çështjet që ka dalë është përdorimi i termit “jurist i shquar” në këtë nen. Ndërsa në nenin 54 përdoret termi “jurist i spikatur”. Duhet të përzgjedhim se cili do të jetë termi më i saktë, që nuk do të na shkaktojë më ato turbullira shqetësime për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të bërë interpretimin e termit.

**Gent Ibrahim** – Druaj se as njëri dhe as tjetri term nuk e zgjidh problemin. Ne thjesht t'i unifikojmë, por qoftë “i shquar” qoftë “i spikatur” ka vend për interpretim.

**Vasilika Hysi** – Cili mendoni se mund të ishte termi më i përshtatshëm? Duhet unifikuar, sepse është përdorur disa herë në tekst.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Do të sugjeroja termin “i shquar”, sepse është edhe në Kushtetutë.

**Vasilika Hysi** – Kam një pyetje lidhur me paragrafin 8 që përdoret këtu. Ju thoni që këshillat verifikojnë pasuritë dhe figurën e çdo kandidati, në fakt janë këshillat që e verifikojnë pasurinë apo është ILKDP-ja dhe këshillat mbledhin informacionin?

Pyetja e dytë që duhet sqaruar është: Këshillat do të bëjnë mbledhjen e gjithë informacionit dhe mbi bazën e tyre do të marrin një vendim? A mund të vendosin ndryshe nga çfarë jep informacion ILKDPI-ja, shërbimi sekret shtetëror e kështu me radhë? Sepse kur thoni këshilli i verifikon dhe vendos mund të ndodhë që këshilli të mos ketë parasysh gjithë këto lloje informacione që vijnë nga institucionet. Pra, mua më shqetëson fjala “ verifikon dhe vendos”.

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Mendoj se kjo ka të bëjë me riformulimin. Ideja është e qartë që vetë këshilli nuk e bën kontrollin e pronës, por është ILKDP-ja që bën të gjithë kontrollin dhe pastaj raporti i ILKP-së do të merret në konsideratë dhe pastaj merret vendimi përfundimtar. Këtë duhet ta sqarojmë në tekst nëse nuk është e qartë si koncept.

**Vasilika Hysi** – Duhet bërë në fakt te neni 37 dhe më pas të reflektojë edhe te dispozitat referuese.

Gjithashtu, lidhur me këtë nen, për pikën 12; këtu thuhet që propozimi për emërimi është i ankimeshëm. Në fakt, ajo që dua të them është se duhet qartësuar, se ku ankimohet, cila është procedura, ka afate.

Pyetja e dytë duhet qartësuar kur bëhet fjalë për propozimin për emërim për vendet e lira në Gjykatën e Lartë. Në rast se nuk pranohet ku do të ankimohet?

**Agnes Bernhard** – (*flet anglisht*) Parashikimi për atë se cili është kompetent për të parë apelimet është te ligji për qeverisjen. Prandaj edhe ne u referohemi vetëm organeve përkatëse, të cilat janë të përcaktuara në ligjin e qeverisjes dhe referenca te neni 46 thotë që është pikërisht te ky nen që shpjegohet më tej se si menaxhohet situata e një aplikanti derisa sa të merret një vendim përfundimtar.

Pra të gjitha vendimet për transferimin për promovimin ka një mundësi apelimi, duke iu referuar këtij neni me procedurën respektive për t’u aplikuar në raste të tilla. Pra, i referohemi nenit 46.

**Vasilika Hysi** – Zoti Ibrahim, a mund t’i referohemi ligjit përkatës ashtu siç tha...?

**Gent Ibrahimi** – Në qoftë se e keni fjalën për forumin e ankimit, forumi i ankimit është për çdo vendim të këshillave është gjykata e apelit administrativ. Në qoftë se e shikoni të arsyeshme që ta përmendni këtu do të duhet të vihet në të gjitha rastet kur parashikohet një vendimmarrje e këshillave dhe mund ta ngarkojë pak tekstin.

**Fatmir Xhafaj** – Pse mendoni se në rastin e vendimit të këshillit për emërimin në Gjykatën e Lartë mund të ketë ankim?

**Gent Ibrahimi** – Normalisht të gjitha janë akte administrative dhe për pasojë do të duhet t’i nënshtrohen ankimit gjyqësor.

**Vasilika Hysi** – Unë iu riktheva nenit 46. Në nenin 46 përmendet vetëm që i emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin.

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, për procedurën apo edhe për vendimin e këshillit për substancën?

**Gent Ibrahimi** - Besoj se fjala është për procedurën. Nuk e kam menduar të them të drejtën nëse dikush mund të ankimohet për thelbin e vendimit, që kandidati iks është më i përshtatshëm se kandidati ipsilon. Nuk e kemi menduar.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo është e rëndësishme. Në qoftë se gjykata i hyn në vlerësimin në meritë pastaj çfarë kuptimi ka e gjithë kjo. Mund të na çonte në situata të paparashikuara dhe gjykata të thoshte në vend të iksit është ipsiloni.

**Gent Ibrahimi** – Dakord, do t’i kushtojmë pak vëmendje kësaj çështjeje për t’i dhënë një rregullim.

**Fatmir Xhafaj** – Neni 54

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 54, i cili bën fjalë për emërimin e kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë, unë shikoj një mospërputhje në formulimin midis pikës 1 dhe paragrafit 2 të Kushtetutës ku bën fjalë. Dua që të përmendim atë përkufizim që përmend gjykata. Këtu thuhet “pozicione të lira”, ndërsa gjykata thotë term tjetër “ 1/5-ta e gjyqtarëve në gjykatë jo e pozicioneve të lira”.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë thotë Kushtetuta?

**Vasilika Hysi** – 1/5 e gjyqtarëve. Ndërsa këtu është thënë “e vendeve të lira”. Na variantin anglisht është sipas Kushtetutës. Në variantin shqip e kufizon këtë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet vënë sipas Kushtetutës.

**Vasilika Hysi** – Madje edhe në variantin anglisht nga verifikimi që i bëra rezulton “të vendeve jo pozicioneve të lira”.

**Fatmir Xhafaj** – Logjika e kësaj është në qoftë se gjykata ka 20 gjyqtarë në çdo kohë 1/5, pra, 4 kanë ardhur prej këtyre, që do të thotë nëse lirohet një vend prej këtyre do të mbushet po prej këtyre. Kjo është logjika.

Në qoftë se është gjyqtar, nuk mund të vijë nga radhët e jogjyqtarëve. Në qoftë se është nga radhët e jogjyqtarëve nuk mund të zëvendësohet me një gjyqtar dhe nuk mund të bëhen më shumë se 5 në atë moment në gjykatë pavarësisht qëllimit. Kjo është logjika edhe e Kushtetutës dhe e ligjit.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, dua nga ekspertët ta saktësojë, do të përdorim “vendet plotësohen” apo “ gjyqtarët përzgjidhen”. Këtu thuhet “plotësohet me juristë të spikatur” . Ndërkohë në Kushtetutë është “përzgjidhet”. Më poshtë këtu thuhet “punonjës të nivelit të lartë”.

**Fatmir Xhafaj** - Të lutem, po flisni për paragrafin e parë? Ai paragraf duhet bërë nga fillimi.

**Vasilika Hysi** - Duhet bërë nga fillimi, por duhet të saktësojmë mirë: çdo punonjës i nivelit të lartë do të punojë në gjykatë apo vetëm juristët, sepse në Kushtetutë thuhet “juristë”, kurse këtu thuhet “punonjës i nivelit të lartë, pa profesion”? Prandaj, nga grupi i ekspertëve dua që paragrafin e parë ta sjellin në formën e kërkesave të Kushtetutës. Janë 4 çështje, që në pamjen e parë duken fjalë, por kanë ndikim në përbërjen e gjykatës, në begraundin e personave që mund të kandidojnë, në kompetencat për zgjedhje, në plotësime e të tjerë.

**Fatmir Xhafaj** - Shikojeni këtë gjë në ligjin “Për shërbimin civil në administratën publike”, se nuk i quan “punonjës juristë”, por ka një titull të caktuar që të kuptohet se për çfarë bëhet fjalë.

**Vasilika Hysi** - Gjithashtu, zoti kryetar, në Kushtetutë ekziston edhe një kriter tjetër për juristët, që kandidojnë për anëtarë të Gjykatës së Lartë, pra kërkohet kriteri i gradës shkencore, por në ligj ky kriter nuk ekziston.

Unë sugjeroj që kriteret kushtetuese duhet të jenë në ligj.

**Fatmir Xhafaj** - Ato janë kritere plotësuese.

**Vasilika Hysi** - Përveç kriterëve plotësuese, ky është një ndër kriteret që ne e kemi vënë si kusht.

**Fatmir Xhafaj** - Ai është një kriter plotësues, është favorizues.

**Vasilika Hysi** - Jo, ne kemi thënë që duhet të jetë. Kriteri i gradës shkencore për juristët përmendet në Kushtetutë, por nuk përmendet në ligj.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* A nuk përmendet grada shkencore në nenin 33?

**Fatmir Xhafaj** - Neni 33 është tjetër gjë, është për formimin fillestar.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Neni 54 kërkon që jo të gjithë kandidatët jogjyqtarë të përmbushin kriteret që janë përcaktuar në nenin 33, nga germa “a” deri te germa “c”. Germa “c” i referohet pikërisht nivelit akademik, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, u sqaruam që ajo i referohet vetëm shkallës master, prandaj duhet të riformulohet.

**Fatmir Xhafaj** - Kjo duhet të riformulohet këtu, sepse nëse riformulohet te neni 33 shpërpjeston të gjithë sistemin.

**Vasilika Hysi** - Gjithashtu, zoti kryetar, unë kam një shqetësim lidhur me pikën 2, germa “b”. Unë mendoj se përmbajtja e germës “b” këtu është shumë më e gjerë se ndalimet kushtetuese.

Në nenin 136, paragrafi 3, si kusht i vetëm është që nuk mund të kandidojnë personat, të cilët mbajnë funksione politike në momentin e emërimit. Ndërkohë, këtu thuhet se nuk mund të jetë anëtar partie në 10 vjetët e fundit. Të jesh një anëtar i thjeshtë partie dhe të mbash një funksion, për mendimin tim, nuk është e njëjta gjë.

**Fatmir Xhafaj** - Ta mbajmë termin kushtetues.

**Vasilika Hysi** - Sugjeroj që duhet mbajtur termi kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** - Pa dyshim.

**Vasilika Hysi** - Gjithashtu, këtu është shtuar fakti që nuk duhet të ketë qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Më falni, a mund ta përsërisë edhe një herë zonja Hysi fjalinë e fundit?

**Vasilika Hysi** - Pra, Kushtetuta ka vendosur disa ndalime dhe një ndër to është “të mos ketë qenë në strukturat drejtuese”.

**Fatmir Xhafaj** - Tani ta përmbledhim në këtë mënyrë: pika “b” të bëhet sipas rregullimit që ka Kushtetuta, me aq kufizime sa e ka parashikuar Kushtetuta, jo më shumë.

Në rregull! Tjetër gjë?

**Vasilika Hysi** - Kam një pyetje lidhur me paragrafin 11 të këtij ligji.

Në paragrafin 11 thuhet : “Gjyqtari me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2/b”. Çfarë ndodh nëse Presidenti nuk e dekreton kandidaturën? Pra, dekretimi këtu është formalisht në bazë dhe në zbatim të ligjit, apo Presidenti ka mundësi zgjedhjeje?

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Në fakt, kjo rregullohet në Kushtetutë dhe mendoj se është te nenin 136, paragrafi i dytë i Kushtetutës, ku sqarohet se dekreti i Presidentit mund të kundërshtohet vetëm një herë dhe e humbet efektin nëse anëtarët e KLD-së kanë votuar kundër dekretit të Presidentit. Mendoj se pyetja juaj gjen përgjigje vetëm në Kushtetutë. Që të mos e përsëris edhe një herë atë që është shkruar në Kushtetutë, ne thjesht duhet t’i referohemi Kushtetutës.

**Vasilika Hysi** - Gjithashtu, po i kthehem çështjes që u diskutua shumë nga zoti Vasili dhe zoti Xhafaj, por edhe nga unë, lidhur me kriteret që duhet të përmbushin ekspertët. Në pikën 6, ku thuhet: “Kandidati duhet të ketë punime shkencore”, ju keni thënë 5 shkrime ligjore; duhet të ketë publikim shkencor dhe shkrim akademik. Pasi verifikova variantin në gjuhën angleze, më rezultoi që këto kërkesa nuk janë sipas këtij varianti, por në vend të fjalës “shkrime ligjore” është “dokumente ligjore”, pra shkrimet nuk janë artikuj shkencorë për të cilat zoti Vasili reagoi.

Së dyti, termi “publikime shkencore” është përmendur saktë, kurse për sa u përket shkrimeve akademike, janë artikuj akademikë. Pra, ne kemi përdorur termin “shkrime akademike”, që është lënda, por këtu duhet të jetë “artikujt akademikë”. Termi “publikime shkencore” është i saktë, kurse ku themi “5 shkrime ligjore” duhet të themi “5 dokumente ligjore”.

Pyetja që kam për zotin Ibrahimimi është: çfarë keni pasur parasysh kur keni thënë “5 dokumente ligjore”? Çfarë keni parasysh kur keni thënë “5 artikuj shkencorë”? Artikulli shkencorë lidhet me fushën ku ai aplikon, për shembull, te seksioni administrativ, apo mund të jetë shumë më i gjerë?

**Gent Ibrahimimi** - Si fillim, ndryshe nga zakonisht, këtu është i saktë versioni shqip dhe jo versioni anglisht, sepse po të themi “5 dokumente ligjore”, i bie që edhe 5 memo që bën për mbikëqyrësin tënd në administratë do të kualifikoheshin. Jo, këtu është fjala për shkrime, ku autori merr guximin t’i bëjë publike në forumet e përshtatshme, kurse për sa u përket shkrimeve akademike, nuk ka ndonjë qëllim, këtu të paktën të jenë në fushën përkatëse.

**Vasilika Hysi** - Thashë artikuj, sepse në variantin anglisht është “artikuj shkencorë”.

**Gent Ibrahim** - Edhe fjala “artikuj” nuk më duket e përshtatshme, sepse forumet, ku mund t’i bësh publike mendimet e tua, janë shumë të larmishme, por kur thua “artikull” duket sikur mendon një revistë apo mendon një gazetë. Kështu që nuk kemi pse ta kufizojmë, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e forumeve. Unë do të isha për fjalën “shkrim”.

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Ne kemi një përkufizim për sa u përket dokumenteve ligjore. Në nenin 2 germa “r” e këtij ligji thuhet: “Për qëllimet e këtij ligji dokumentet ligjore përfshijnë çdo dokument që është përgatitur nga personi gjatë ushtrimit të detyrës së tij, duke përfshirë këtu edhe raportet apo vendimet ligjore që ky person ka dhënë gjatë ushtrimit të detyrës së tij”. Përveç këtyre dokumenteve ligjore që ata kanë përgatitur gjatë punës së tyre, mund të kenë edhe punë akademike apo shkencore që i kanë bërë shtesë. Pra, kjo do të ishte një vlerë shtesë.

**Gent Ibrahim** - Dokumenti ligjor përcaktohet në kontekstin e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Pra, dikush vë në dispozicion 5 memo apo 5 vendime gjyqësore që i ka hartuar vetë për të treguar se ai është një jurist i zoti. Nuk besoj se do ta përdorim këtë koncept si kriter për anëtarët e Gjykatës së Lartë, por aty duhet të jetë fjala për diçka më tepër se sa hartimi i 5 dokumenteve të punës.

**Vasilika Hysi** - Në fakt, jam dakord me sugjerimin e zotit Ibrahim, por njëkohësisht dua të mbajmë një qëndrim për ta finalizuar këtë dispozitë dhe për të proceduar me nenin që vjen më pas.

**Fatmir Xhafaj** - Kjo të krijon përshtypjen se këshilli emëron atë që është më i lartë se të tjerët. Jo, këshilli propozon dhe nuk niset nga renditja, pra këshilli i ka dhënë fund dhe renditja nuk ka rëndësi për të. Ky këshill nuk është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bën propozimin e të gjithë kandidatëve, sepse rankimi është një çështje e brendshme e tyre, dhe thotë se ky kandidat është për Gjykatën e Lartë dhe kaq. Më pas propozimin ia dërgon Presidentit, i cili ia kthen Këshillit të Lartë Gjyqësor në mënyrë të arsyetuar, nëse këshilli nuk bie dakord vazhdon procedura tjetër. Pse duhen të gjitha këto fjalë parazitare, jo ai e që renditet i pari e të tjerë? Nuk e kuptoj se çfarë keni dashur të bëni?

**Vasilika Hysi** - Zoti kryetar, kapët një pikë interesante, që mua më ka shpëtuar nga lodhja. Në fakt, në pikën 9 thuhet: “Këshilli i Lartë propozon me shkrim”, në pikën 10 thuhet:

“Vendimi i propozimit për emërimin është i ankimeshëm”. Ne duhet të vendosim: “Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatit apo merr vendim për emërimin e tij”?

**Fatmir Xhafaj** - Rishikojini edhe një herë këto pika.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

A jeni dakord me nenin 54, me ristrukturimet që janë bërë te pikat 1, 2, 8, 9, 11?

Po, keni diçka?

**Agnes Bernhard** - *(flet anglisht)* Mendoj se na duhen disa kritere për të bërë selektimet, sepse shumë kandidatë mund të jenë të përshtatshëm të kandidojnë, por më pas na duhet një lloj rankimi, listimi dhe kjo bëhet në bazë të meritave të kandidatëve respektivë. Një nga mjetet për të vlerësuar meritat e kandidatit është të bëhet një kontroll i asaj çka ata kanë nxjerrë, si i kanë nxjerrë ata dokumentet e tyre deri në ato momente. Bazuar në këtë vlerësim objektiv ata duhet të përcaktojnë arsyetimet dhe renditjet e tyre dhe kjo listë do t'i dorëzohet në fund Presidentit.

**Fatmir Xhafaj** - Presidentit nuk i dorëzohet lista, por i dërgohet propozimi me emrin e kandidatit. Presidenti nuk zgjedh ndërmjet kandidatëve që janë në listë. Lista është për efekt transparence, për të bërë publike rezultatet e një gare. Presidentit i dërgohet një emër, nëse është një vend, nëse janë dy vende i çohen dy emra dhe nuk i çohet e gjithë lista. Për Presidentin nuk ka rëndësi rankimi, që të jemi të qartë për këtë gjë.

Absolutisht ju keni të drejtë për pjesën e vlerësimit, nuk e përjashtoj këtë gjë, sepse do të bëhet vlerësimi me meritë, do të bëhet vlerësimi i dosjes e të tjerë, por kjo është deri në momentin që shpallet kandidati për efekt transparence dhe për efekt ankimi për procedurat që folëm pak më lart. Lista nuk shkon te Presidenti, nuk thuhet kanë konkurruar 10, i pari është ky, i dyti është ky, sepse Presidenti nuk zgjedh ndër ta, por i dërgohet vetëm emri i nominuar nga këshilli dhe ai vendos për këtë emër vetë nëse krijon bindje.

**Agnes Bernhard** -*(flet anglisht)* Jam dakord.

**Gent Ibrahimi** - Ky diskutim më kujtoi diçka, është një frazë në Kushtetutë, që unë personalisht e kam hequr dy herë dhe nuk e di se si kthehet prapë. Për të evituar këtë keqkuptim, që tha zoti Xhafaj tani, në neni 136, paragrafi 2 i Kushtetutës duhet hequr fraza: “Kriteret e kualifikimit”. Aty thuhet: “Kur Presidenti konstaton se kandidati nuk i plotëson kriteret e kualifikimi (pra i bie që Presidenti të futet në gjykimin e meritave të kandidatit) dhe kushtet e zgjedhshmërisë”. Ajo duhet lënë vetëm: “kushtet e zgjedhshmërisë”, pra nëse kandidati i ka apo



nuk i ka vitet e eksperiencës, i ka apo jo gradat shkencore dhe kaq. Presidenti nuk duhet të futet te kriteret e kualifikimit, sepse kjo gjë i hap rrugë problemit që identifikuat ju.

**Fatmir Xhafaj** - E mbyllim nenin 54?

**Vasilika Hysi** - Ka një pikë që do të na hapë debate.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, do ta shikojmë kur të shënohen ndryshimet.

**Vasilika Hysi** - Dua ndihmën e ekspertëve për mënyrën se si këshilli rendit kandidatët. Në pikën ku thuhet: “Kur kandidatët kanë aftësi të njëjta”, nuk arrij ta kuptoj pjesën e aftësive. Unë them se duhet të kenë vlerësime të njëjta, pra për t’i zgjedhur duhet të mbahet parasysh eksperiencia profesionale e përshtatshme për pozicionin.

**Fatmir Xhafaj** - Të lutem, se e gjitha kjo është një vlerësim subjektiv!

**Vasilika Hysi** - Është subjektiv, por si mund ta rregullojmë?

**Fatmir Xhafaj** - Kur kanë aftësi të njëjta, vendoset i pari ai që ka arritur i pari vijën e finishit.

**Vasilika Hysi** - Këtë dua atë them, pra si mund ta rregullojmë këtë formulim?

**Fatmir Xhafaj** - Hiqeni fare, se është formulim parazit, sepse nuk dalin kurrë dy shqiptarë të barabartë kur vendosin 11 të tjerë. Çfarë po thoni? Pse në maratonë janë ata që kush takon finishin i pari apo janë te Formula Uno se kush do ta fusë i pari turirin e makinës? Çfarë bëni kështu, mos kaloni në ekstremitete? Këtu kanë dalë me 50 pikë diferencë dhe kanë nxjerrë të parin atë që ka dalë i 7-ti. Pra, të hiqet fare kjo pjesë dhe e mbyllim nenin 54.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 55.

**Vasilika Hysi** - Te neni 55 për rregullin e përgjithshëm për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm kam një pyetje: te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit” hera-herës, kur rregullojmë aspekte të veçanta të prokurorit, i referohemi ligjit “Për prokurorinë”. Pse nuk kemi thënë edhe dy fjalë se si emërohet prokurori i Përgjithshëm?

**Fatmir Xhafaj** - Është atje pse duhet të bëjmë përsëritje.

**Vasilika Hysi** - Po pse për prokurorët e tjerë kemi folur këtu dhe vetëm për prokurorin e Përgjithshëm kemi folur atje?

**Fatmir Xhafaj** – Po, kemi folur këtu, sepse këtu është emërimi.

**Vasilika Hysi** – Vetëm prokurorin e Përgjithshëm kemi shkëputur nga ky ligj.

**Fatmir Xhafaj** - Sepse ai ligj është vetëm për prokurorin e Përgjithshëm, ai e rregullon lëvizjen e tij.

**Vasilika Hysi** – Unë nuk jam relatorja e atij ligji, prandaj po bëj një pyetje, zoti kryetar, që ta kemi parasysh se si mund të koordinojmë të gjitha ligjet dhe të rakordojnë.

**Fatmir Xhafaj** - Të lutem, edhe një herë: te ligji “Për prokurorinë” nuk ka parashikime për prokurorin e thjeshtë. Ne këtu e kemi kaluar, apo nuk e mbani mend? Nuk thuhet kështu: “Gjenden në ligjin “Për prokurorinë””.

**Vasilika Hysi** - Kur e kemi formuluar kemi thënë: “Rregullat për procedurën dhe kriteret e emërimit të prokurorit të Përgjithshëm parashikohen në ligjin në fuqi “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”. Unë nuk e lexova, pasi është tabela para për riformulimin.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord!

**Vasilika Hysi** - Lidhur me nenin 56, zoti kryetar, këtu flitet vetëm për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë, ndërkohë në tekst unë gjej fjalë si “zgjedhja e kryetarit të prokurorisë” e të tjerë. A është bërë këtu një lapsus apo bëhet fjalë edhe për zgjedhjen e prokurorit? Fjala “prokuror” përdoret në paragrafin e dytë dhe në paragrafin e katërt, ndërkohë që titulli bën fjalë vetëm për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

**Agnes Bernhard** *-(flet anglisht)* Ndoshta ky mund të jetë një gabim, që ka mbetur aty për shkak të ndryshimeve përfundimtare në draftin kushtetues.

Fillimisht kryeprokurori duhej të zgjidhej midis gjyqtarëve, por më pas u ndryshua, prandaj kjo pjesë duhet të rregullohet, në mënyrë që të jemi në përputhje me Kushtetutën.

**Fatmir Xhafaj** - Këto duhet të hiqen pasi janë parazitare, të panevojshme.

**Agnes Bernhard** *-(flet anglisht)* Është vetëm për kryetarin e Gjykatës së Lartë, sepse ai është i vetmi, i cili zgjidhet midis kolegëve të tij.

**Vasilika Hysi** - Kam një pyetje lidhur me kriteret që duhet të përmbushë kryetari në Gjykatën e Lartë. A është normale që të zgjidhet kryetar në Gjykatën e Lartë një person që mund të ketë masa disiplinore në të kaluarën, por që nuk i ka në fuqi? Ndërkohë, në ligj, për disa pozicione të tjera, kemi kërkuar që të mos ketë masa disiplinore as në të kaluarën as në fuqi.

Së dyti, në pikën 5, lidhur me procedurën, kërkoj nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë që ta riformulojnë këtë pikë për të shmangur “referencat e referencës së referencës”, sepse personalisht e kisha të vështirë ta riformuloja. Gjithashtu, në pikën 6 ju keni thënë që votimi për zgjedhjen e kryetarit bëhet me shumicë absolute, por, nga ana tjetër, thoni se duhet të jetë me

2/3-at e anëtarëve dhe është detyrim ta votojnë të gjithë. A nuk është kontradiktore? Sepse, nga një anë thoni se të gjithë magistratët janë të detyruar të votojnë, madje fusni edhe ndihmësmagjistratët.

Pyetja ime është: pse duhet të votojnë ndihmësmagjistratët për të zgjedhur kryetarin e Gjykatës së Lartë?

Së dyti, nëse duhet të jenë 2/3-at, (sepse ju thoni që detyrimisht duhet të votojnë 2/3 – at), atëherë pse kërkoni që të votohet me shumicë absolute? A mendoni se këtu përfshihen edhe votat kundër? Pra, duhet të votojnë 2/3-at dhe më pas ndarja pro ose kundër përcakton atë që quhet shumicë absolute. Këtë pjesë dua që ta saktësoni më mirë në ligj.

Gjithashtu, në pikën 7 flitet për magistratin ku thoni: “Në qoftë se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë numrin e nevojshëm të votave, një votim i dytë mbahet ndërmjet dy kandidatëve që kanë pasur numrin më të madh të votave”. Më pas thuhet: “Zgjidhet magjistrati me eksperiencë profesionale më të gjatë”. Këtu bëhet fjalë për një eksperiencë më të gjatë në gjykatë apo për eksperiencë më të gjatë profesionale në jetën e tij? Edhe kjo pikë duhet saktësuar.

Këto pyetje kisha, ndërsa pikën tjetër e kam riformuluar sipas tabelës: “Këshilli miraton rregulla të detajuara për procedurën e mbledhjes së përgjithshme, votimin, mënyrën e numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit”.

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Çështja e shumicës parashikon që duhet të jenë të pranishëm të paktën 2/3-at dhe kuorumi i të votuarit është shumica absolute e votave të të gjithë anëtarëve. Është një kuorum i lartë, por sigurisht që kryetari duhet të jetë një person, i cili gjen mbështetjen dhe pëlqimin e kolegëve të tij.

Paragrafi tjetër është një mekanizëm zhblloqes, pra kur nuk arrihen 2/3-at e anëtarëve ndiqet modeli që parashikohet te ligji “Për Konferencën Kombëtare të Gjyqtarëve” për zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit.

Për pjesën tjetër, për riformulimin, ne duhet të shikojmë tabelën që keni parashtruar ju.

**Vasilika Hysi** - Por lidhur me personin me eksperiencë më të gjatë, a bëhet fjalë për eksperiencë më të gjatë në gjykatë apo në karrierë?

**Agnes Bernhard** - (*flet anglisht*) Ky formulim në këtë pikë lidhet me përvojën më të madhe si magistratë gjatë gjithë jetës si gjyqtar, por jo domosdoshmërisht në gjykatë. Ndërsa, përvoja minimale në gjykatë është 3 vjet, që përcaktohet në paragrafin 2.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

Atëherë, kalojmë te neni tjetër, zoti kryetar?

**Fatmir Xhafaj** - Po.

**Vasilika Hysi** - Neni 57 “Emërimi i kryetarëve të tjerë”. Këtu në këtë nen flitet për kryetarin e gjykatës dhe të prokurorisë, duke përjashtuar prokurorin e Përgjithshëm.

Unë kam një pyetje për pikën 2, ku thuhet: “Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kryetari, i cili nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar”. Në cilin moment konsiderohet i dorëhequr si kryetar, në momentin kur i mbaron mandati apo në momentin që duhet aplikojë për një mandat të dytë?

Në pikën 4 thuhet: “Këshilli vlerëson kërkesat e kandidatëve për rizgjedhje, pasi ka përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe vlerësimin e veprimtarisë të kryetarit”. Këtu bëhet fjalë kur njëri nga kandidatët konkurron? Sepse kryetari do të kërkojë të rizgjidhet.

Lidhur me pikën 7, për thirrjen mbledhjes, dua t’i kërkoj grupit të ekspertëve të bëjë një riformulim më të qartë. Ne kemi bërë një riformulim, por do të doja patjetër mbështetjen tuaj. Këto janë çështje shumë delikate në procedurë dhe çdo ndryshim i radhës së fjalëve mund të dëmtojë kuptimin e nenit, prandaj kërkoj riformulimin e pikave 3, 4, 7, gjithashtu, edhe pikave 8, 9,10,12. Dua konfirmim nga ekspertët, pasi ta kenë lexuar me vëmendje.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Në rregull për riformulimin, ndërsa për sa i përket të kuptuarit të paragrafit 2, në fakt, aty nënkuptohet “në fund të mandatit”. Kjo ndoshta duhet sqaruar më mirë në tekst, por ky është kuptimi.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 58: “Parimet e komandimit të magjistratëve”.

**Vasilika Hysi** – Do të doja që komentet që kemi bërë te përkufizimet të përfshiheshin në ligj.

Në qoftë se ju kujtohet, kur kemi diskutuar nenin “Përkufizimet”, kemi dhënë disa përkufizime shumë të detajuara. Do të ishte më mirë që përkufizimet për të kuptuar se çfarë do të thotë “komandim”, “institucion i komanduar”, të jenë këtu, në këtë nen. Nëse ju kujtohet, e kam bërë këtë kërkesë. Është më mirë këtu, pasi unë gjatë leximit të këtij neni, detyrohesha t’i

kthehesha nenit të përkufizimeve për të kuptuar të gjithë terminologjinë që është përdorur në këtë nen.

Gjithashtu, kemi bërë disa riformulime të pikave 2, 5, 8, 10, për të cilat do të doja opinionin e ekspertëve të nivelit të lartë, qoftë të EURALIU-it, qoftë edhe të ekspertëve shqiptarë.

Te pika 7 e po këtij neni, “Komandimi i magistratëve”, kam përsëri një pyetje: Kur flitet për komandim të magistratëve, është fjala edhe për në prokurori, edhe për në gjykatë apo vetëm për në gjykatë? Gjithashtu, te përkufizimi për magistratët thuhet se magistratë janë vetëm gjyqtarët, ndërsa te ndihmësgjyqtarët, ne kemi përfshirë edhe prokurorë. Këtë do të doja ta saktësoja këtu te “Komandimi i magistratëve”. Kur flasim për komandim të magistratëve, kemi parasysh edhe ndihmësmagjistratët, sepse te përkufizimi thuhet që në nocionin “magjistrat” përfshihen, në raste të përcaktuara, edhe ndihmësmagjistratët?

Gjithashtu, në pikën 9 thuhet: “Magjistrati vlerësohet nga pikëpamja profesionale dhe etike”, po për kandidatët jogjyqtarë, i kemi parasysh të dyja vlerësimet? Unë mendoj se duhet të jenë të dyja, edhe profesional dhe etik.

Gjithashtu, çfarë kuptojmë kur themi: “Vlerësoj kandidatin jogjyqtar në Gjykatën e Lartë”?

**Fatmir Xhafaj** – Për pikën 9, edhe unë jam me zonjën Hysi, që është parazitare. Është shkruar nga ndonjë njeri që ka parasysh situatën se çfarë ndodh tani me sistemin e vlerësimit, se nuk ka mundësi. Nuk e kuptoj dot se si mund të mos jetë i vlerësuar e të tjera. Kjo është e shkruar nga njerëz, që e dinë se si është situata e tanishme. Pa dyshim, situata tani është skandaloze. Kjo është logjika që i përgjigjet realitetit të sotëm. Po flasim për një gjë që do të duhet të jetë krejt ndryshe, për një këshill, që do të funksionojë me kohë të plotë dhe që vlerësimin dhe rivlerësimin e gjyqtarëve e ka në detyrat parësore.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sa të duash, por logjika e këtij ligji këtë do të përmbysë, këtë situatë.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Këtu dalin disa çështje. Termi “magjistrat” u referohet gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ky është përkufizimi, ndërsa për sa i përket komandimit, ai është i hapur për të dy, për gjyqtarët dhe për prokurorët.

Për sa i përket vlerësimit, ne duhet të marrim parasysh se komandimet mund të bëhen në institucione të ndryshme. Nëse komandimi bëhet në pozicionin e një ndihmësmagjistrati në

Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese, atëherë këta persona duhet t'i nënshtrohen skemës së vlerësimit të institucionit ku do të komandohen.

Nuk e di nëse ndihmësgjyqtarët në Gjykatën Kushtetuese do t'i nënshtrohen një vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese. Besoj se nuk ka ndonjë skemë vlerësimi të disponueshme në Gjykatën Kushtetuese.

Për sa i përket komandimit në Ministrinë e Drejtësisë, ajo mund të mos i vlerësojë gjyqtarët, me qëllim që të shmangim që gjyqtarët, të cilët nuk janë vlerësuar gjatë mandatit të tyre, pra gjatë mandatit të tyre, ata kanë qenë të komanduar në një institucion tjetër, por të kenë këtë avantazh në fund të komandimit të tyre. Kur i kthehemi transferimit apo ngritjes së tyre në detyrë, ne kthehemi në një rregull, i cili parashikon se si duhet të trajtojmë aplikimet për gjyqtarët, që vijnë nga pozicione, të emëruar tashmë dhe ata të transferohen ose të ngrihen në detyrë.

Paragrafi 9 përpiket të mbushë këtë zbrazëti dhe përpiket të japë edhe një rregull për atë situatë ku, për shembull, gjyqtarët që janë në Gjykatën Kushtetuese apo në Ministrinë e Drejtësisë, nuk janë vlerësuar gjatë mandatit të tyre në këto 2 institucione.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo nuk është e shkruar shqip.

E dyta, kur thuhet: "...si kandidat jogjyqëtar në Gjykatën e Lartë", kjo e deformon tërësisht qëllimin e nenit. Kandidatë jogjyqëtarë në Gjykatën e Lartë janë ata që nuk vijnë nga magistratura, pra është ajo 1/5, 20%-shi për të cilët folëm pak më lartë, pra, thuhet: "kandidatë jogjyqëtarë", në fakt, këta janë gjyqtarë, por këtu është fjala për t'i vlerësuar në periudhën që nuk shërbejnë si gjyqtarë, por shërbejnë në Ministrinë e Drejtësisë, në Gjykatën Kushtetuese e të tjera. Pra, do të duhej të thuhej më thjeshtë, që të gjendej një sistem vlerësimi për ata gjatë gjithë kohës, sepse ai mund të qëndrojë 5 vjet atje, por 5 vjet, ai do të rri pa u vlerësuar? Jo, ai do të vlerësohet çdo vit, si të gjithë kolegët e tjerë, por do të vlerësohet për pjesën që i është lënë detyrë. Këshilli do të vendosë disa kritere; ai që shkon ndihmës në Gjykatën Kushtetuese duhet të ketë 1, 2, 3, 4, 5 gjëra dhe në bazë të tyre do të vlerësohet si gjithë të tjerët. Pse duhet të presë 5 vjet dhe pastaj të vlerësohet? Pra, "kandidatë jogjyqëtar" nuk ka kuptim fare.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë kam një pyetje, sepse ndoshta nuk u shpreha qartë.

Kriteret me të cilat do të përzgjidhen kandidatët jogjyqëtarë, do të shërbejnë edhe për vlerësimin e tyre? Mos bëhet fjalë për kriteret?

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem, mos u ngatërro! Nuk është për këtë gjë. Është për vlerësimin e atyre, që nuk janë atje.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atëherë, dakord me nenin 58 për të bërë reflektimet, që thamë.

**Agnes Bernhard** –*(flet anglisht)* Mund ta sqarojmë këtë gjë.

Dua të bëj një sqarim se pse bëhet lidhja me vlerësimin e meritave profesionale për jogjykatësit në Gjykatën e Lartë, në parashikimin për emërimin e anëtarëve jogjyqtarë në gjykatë. Kemi parashikuar një skemë se si t’i vlerësojmë këta kandidatë. Për të mos e përsëritur këtë gjë, i jemi referuar atij parashikimi, por ndoshta duhet ta bëjmë më të qartë se si do të aplikohet kjo skemë vlerësimi për ata që nuk janë nën skemën e vlerësimit të gjyqtarëve.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet bërë vetëm një shtesë, ku të thuhet: “Nuk duhet të ketë gjyqtar, pavarësisht se ku shërben, që të mos vlerësohet periodikisht sipas procedurës së vlerësimit”. Le të vendosë këshilli kritere dhe të thotë: ata që janë në Ministrinë e Drejtësisë do të vlerësohen sipas këtyre kritereve; do të vlerësohen për etikën, për anën profesionale, me kritere të ngjashme siç vlerësohet pjesa jogjyqtare e të tjera. Për analogji, le ta zgjedhë këshilli, por ata duhet të vlerësohen dhe të mos ngelen asnjë periudhë pa u vlerësuar. Ata duhet t’i nënshtrohen rregullisht procedurës së vlerësimit, pavarësisht se ku janë.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Kjo është ideja e këtij ligji, por ndoshta duhet ta bëjmë më të qartë.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit për mirëkuptimin!

Vazhdojmë me nenin 59: “Procedurat e komandimit”.

**Vasilika Hysi** – Në lidhje me nenin 59 “Procedurat e komandimit”, kemi bërë një riformulim të pikave 1,3 dhe 6, për të cilat kërkoj opinionin e ekspertëve.

Gjithashtu, për pikën 4 kam dy pyetje:

Në pikën 4 ju përmendni 2 terma, që kanë nevojë të sqarohen: “Këshilli brenda dy javëve, pas afatit të kandidimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe i mbështet ata”. Në çfarë kuptimi “i mbështet ata”? Është i detyruar t’i mbështesë, apo mund të mos i mbështesë?

E dyta, ju thoni: “...i mbështet kandidatët për pozicionet e komanduara, kandidim, i cili nuk është në konflikt me interesat e larta të zyrës”. Cili është kuptimi i termi “interesat e larta të zyrës”?

Gjithashtu, sugjeroj, ndoshta mund ta kem gabim, por në përgjithësi në ligj duhet të flasim në numrin njëjës, sepse hera-herës përmendet fjala “magjistratë” në shumës dhe herë përdoret “magjistrati” në njëjës. Do të doja, ndoshta edhe përvojën e zotit Ibrahimimi dhe të zonjës Agnes për ta unifikuar, sepse, në paragrafë të ndryshëm, përdoret një herë në njëjës, një herë në shumës. Këto kam për këtë nen.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në lidhje me termat, do të kontrollohen, pra që të përdorim gjithandej numrin njëjës. Kështu duhet të jetë edhe rregulli.

Në lidhje me pyetjen nëse këshilli është i detyruar të mbështesë, po, ideja është që janë të detyruar të japin mbështetje. Vetëm nëse ka arsye për të thënë që një gjyqtar del jashtë sistemit, atëherë gjykata dështon, mbyllet, pra ka arsye të fuqishme, që dëmtojnë seriozisht funksionimin e sistemit nëse një gjyqtar është i komanduar.

**Vasilika Hysi** – Po termi “Interesat e lartë të zyrës ...”

**Fatmir Xhafaj** – E kanë përkthyer gabim. Të cilës zyre? Ata janë gjyqtarë dhe prokurorë, pra interesat e larta të gjykatëse dhe prokurorëve ku punojnë ...

**Gent Ibrahimimi** – Ndoshta një përkthim i mirë mund të kishte qenë: “Nuk bie ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrave në gjykatën nga ku ai vjen”.

**Fatmir Xhafaj** – Nga gjykata ose nga prokuroria nga vjen. Kjo është e thjeshtë fare.

**Gent Ibrahimimi** – Për shembull, unë punoj në Tiranë dhe dua të delegohem në Ministrinë e Drejtësisë. Këshilli do të më mbështes mua, në rast se sigurohet që largimi im nuk komprometon ecurinë e punës në gjykatën nga ku unë vij.

**Fatmir Xhafaj** – Shumë faleminderit!

Sikur të ishte shkruar kështu, do të na ishte kursyer i gjithë debati për këto terma.

Dakord për nenin 59 me ndryshimet e propozuar? Dakord.

Neni 60.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 60, unë kam disa pyetje.

Këtu thuhet: “Inspektori duhet të jetë vetëm magjistrat”. Ky është kriter?

E dyta, në paragrafin 4 të nenit 58, thuhet: “Një person mund të komandohet jo më shumë se 5 vjet”, ndërkohë këtu u është dhënë e drejta inspektorëve të punojnë 2 herë nga 5 vjet, pra 10 vjet, me të drejtë riemërimi. A nuk ka një kontradiktë, pavarësisht se komandimi në total, si përjashtim, mund të jetë deri në 10 vjet, por, si rregull, thuhet se duhet të jetë jo më shumë se 5 vjet? Pse te rasti i zyrës së inspektorit sugjerohet që inspektori të jetë dy herë nga 5 vjet?



Gjithashtu, në paragrafin 4 thuhet: “Magjistratët mund të komandohen si inspektorë në zyrën e inspektorit për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rikomandimi, kur janë vlerësuar së paku me rezultatin “shumë mirë” në vlerësimin etik, si inspektorë”. Po inspektorët e tjerë që nuk vijnë si magjistratë, si do të vlerësohen? Duhet të jenë patjetër magjistratë që të vazhdojnë të jenë inspektorë në zyrën e inspektimit?

E fundit, ju thoni: “Inspektorit sapo i mbaron mandati, i ofrohet automatikisht pozicioni në nivel apeli”. Nëse nuk ka vend, çfarë bëhet në këtë rast?

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Në lidhje me termin “vetëm” në paragrafin e parë, ky term mund të hiqet pa e prishur kuptimin.

Në lidhje me pyetjen se pse mund të kenë një mandat të dytë dhe pyetjet në vijim, shqetësimi që është shprehur fuqishëm në grupet tona të punës, është se në njërën anë, ne do të donim të kishim një inspektorat shumë të fuqishëm, një vend ku njerëzit mund të adresohen, ku njerëzve t’u garantohet që në të ardhmen, vetë pastrimi i sistemit do të funksionojë. Prandaj, na duhen disa stimuj për gjykatës të mirë, që të tërhiqen dhe të shkojnë në inspektorat. Gjithashtu, duke folur edhe me gjykatësit, kemi kuptuar që ata nuk e pëlqejnë atë punë, pra na duhet të parashikojmë disa kritere më tërheqëse.

Pse dy mandate? Situata ideale do të ishte që në inspektorat të kishim magjistratë në fund të mandatit të tyre. Për shembull, një magjistrat, që është 55 vjeç, mund të shërbejë aty deri në fund të mandatit pa pasur frikë që në fund të mandatit, ai do të kthehet përsëri në sistem dhe kolegët e tij do ta urrejnë atë, sepse në një moment të caktuar mund t’i ketë pushuar nga puna. Pra, kjo do të ishte mundësia për të rinovuar. Gjithsesi, është në përputhje me 10-vjeçarin e komandimit që kemi parë për magjistratët.

Gjithashtu, përcaktimi dhe emërimi në një pozicion apeli, i shërben të njëjtit qëllim për të pasur njerëz të mirë dhe që kanë shërbyer mirë për disa vite, për aq kohë sa ata nuk kanë frikë se do të humbasin pozicionet e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Kështu siç e parashtruat ju, është mirë. Edhe unë ju mbështes në këtë parashtrim, por shqipërimi ose shkrimi i tekstit është shumë i dobët. Ideja e mirë që keni pasur është prishur rrugës, duke u shkruar.

**Ulsi Manja** – Ky ndoshta është institucioni më i rëndësishëm në të gjithë këtë reformë që po ndërmarrim në sistemin e drejtësisë, sepse lidhet drejtpërsëdrejti me atë mungesë efikasiteti që e ka shoqëruar deri më sot sistemin, që është mungesa e kontrollit dhe e

llogaridhënies. Tani, qenia inspektor i lartë i drejtësisë, sigurisht që këtu u përdor termi që duhet të jetë patjetër magistrat dhe shumë mirë është...

**Fatmir Xhafaj** – Jo inspektor, por inspektor i lartë i drejtësisë.

**Ulsi Manja** – Jo, kryeinspektori, inspektorët.

Po flas për inspektorët që do të shkojnë në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.

Natyrisht, si formë është zgjedhur komandimi. Unë mund të jem gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë, mund të jem gjyqtar në Gjykatën e Apelit dhe komandohem në pozicionin e inspektorit, atëherë pyetja ime është: Personi komandohet në këtë pozicion për efekt të trajtimit që gëzon nëpërmjet statusit si anëtar i Gjykatës së Lartë? Pra, për efekt të trajtimit të të gjitha benefiteve që ka një anëtar i Gjykatës së Lartë? Ky është kuptimi i nenit 60?

**Fatmir Xhafaj** – Ideja këtu nuk është që ai të garantojë benefitet pasi shkon atje, por ai duhet t'i ketë plotësuar kushtet përpara, pra nga do të vijnë inspektorët në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Do të vijnë nga ata që plotësojnë kriteret si magistratë në Gjykatën e Lartë. Pra, do të thotë: nëse ne kemi 50 apo 100 magistratë, të cilët në kushte normale plotësojnë kriteret për të konkurruar për Gjykatën e Lartë, vetëm ata mund të jenë pjesë e atyre që mund të komandohen për inspektorë.

**Ulsi Manja** – Nëse kjo është përgjigja, atëherë lind pyetja tjetër: Pse duhet të shfaqë interes një gjyqtar, një prokuror apo më saktë një magistrat, që plotëson kushtet për të shkuar në Gjykatën e Lartë, që të pranojë komandimin si inspektor? Cili do të ishte interesi?

**Fatmir Xhafaj** – E para, një nga interesat e tij është se, nëse ai është në Shkallë të Parë, do të kalojë direkt në Apel, kur të mbarojë, pra është kandidat i mundshëm për në Apel. Është benefit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të ketë vend. Ai është i avantazhuar.

**Gent Ibrahimi** – Gjithashtu, do të paguhet si gjyqtar i Gjykatës së Lartë gjatë kohës kur punon në inspektorat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo nuk del këtu. Ky fakt është te ligji tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Sepse përderisa ai i plotëson kriteret ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** -...do të vazhdojë punën si inspektor.

**Vasilika Hysi** – Ky lloj sistemi, që me të drejtë duket si një zhvillim karriere brenda sistemit, a mund të krijojë disbalanca, që disa njerëz nëpërmjet komandimit që mund t’u bëjnë këshillat, të kapërcejnë në nivele të tjera, duke marrë përfitime, që pasi të mbarojnë mandatin të kthehen në një nivel më të lartë?

**Fatmir Xhafaj** – Por do të punojë 10 vjet. Po punoi për 10 vjet shumë mirë në zyrën e inspektorit të lartë, bravo i qoftë, e meriton të shkojë atje, sepse duhet të kesh parasysh që ka shërbyer si inspektor për të gjykuar të tjerët, duhet të ketë edhe një benefit. Ka qenë kontrollor për kontrollorët.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, unë jam dakord me atë që tha zonja Agnes, 10 vjet. Në qoftë se ai mbaron 30 vjeç Magjistraturën, punon 10 vjet, 40 vjeç të shkojë inspektor dhe pasi të mbarojë atë mandat, të rikthehet përsëri, sa objektiv do të jetë ai kur mendon që ka edhe 20 vjet punë për të bërë? Unë do të isha të kishte një kriter, që të shkonte në një moshë sa më të vjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por të lutem ki parasysh që nuk shkon njeri me qejf. Prandaj janë vendosur kritere, që të mos shkojnë inspektor njerëz pa cilësi. Ai që nuk ka çfarë të bëjë në karrierën e vet dhe mblidhen të gjithë, siç ndodh sot, në zyrat e inspektoratit, që sapo folëm. Këta synojnë të rrisin cilësinë e inspektoratit dhe kanë caktuar disa incentiva që do ta stimulonin këtë përpjekje për të shkuar atje dhe kanë bërë mirë. Këtu duhet të jemi dakord.

Dakord me nenin 60.

Neni 61.

**Vasilika Hysi** – Për nenin 61 ka vetëm një riformulim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 62. Dakord me vërejtjet dhe sugjerimet e bëra.

Neni 63. Dakord me vërejtjet dhe sugjerimet e bëra në tabelë.

E mbyllim këtu.

Do të vazhdojmë me nenin 64: “Emërim i përkohshëm” ditën e mërkurë..

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po çfarë problemi ka? Ju sikur jeni të gjithë sikur mbani iftar.

**Agnes Bernhard** – *(flet anglisht)* Dakord. Takohemi nesër.

**Vasilika Hysi** - ... të paktën të bazuar edhe në shumë riformulime që janë bërë dhe janë në tabelë, t’i pastronim dhe të kishim një ide...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Atëherë, ditën e mërkurë nuk do të bëjmë mbledhje të Komisionit të Ligjeve, por do të merremi vetëm me këtë që ta mbyllim.

Ndërkohë, a mund të takoheni nesër, ju me Vasilikën se çfarë pyetjesh ka paraprakisht, që t’i qartësojë. A mund të takoheni? Edhe me praninë time? Dakord. Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*